



ANALIZË E SHKURTËR

DIALOGU KOSOVË – SERBI: SFIDAT DHE RRUGA PËRPARA

MARS, 2018



DEMOKRATIZIMI
DHE PRAKTIKAT
PARLAMENTARE



COPYRIGHT © 2018. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +381 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Ueb: www.kdi-kosova.org

Vërejtje: Ky raport është rezultat i një hulumtimi që është realizuar në kuadër të projektit "Forcimi i mbikëqyrjes parlamentare të ekzekutivit dhe rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në dialogun Kosovë-Serbi", i financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës.

ANALIZË E SHKURTËR

DIALOGU KOSOVË – SERBI: SFIDAT DHE RRUGA PËRPARA

MARS, 2018



PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
HYRJE	6
DIALOGU KOSOVË-SERBI.....	7
DIALOGU GJATË QEVERISË THAÇI II	7
DIALOGU GJATË QEVERISJES MUSTAFA	10
DIALOGU GJATË QEVERISË HARADINAJ	12
PLATFORMAT E QEVERISË PËR DIALOGUN KOSOVË-SERBI	13
ZBATIMI I MARRËVESHJEVE DHE DYKUPTIMËSIA KONSTRUKTIVE.....	14
MUNGESA E TRANSPARENCËS	19
LLOGARIDHËNIA.....	21
RRUGËTIMI DREJTË BE-SË.....	22
DIALOG I BRENDSHËM NË SERBI	24
PARIMET BAZË PËR FAZËN E RE TË DIALOGUT KOSOVË-SERBI.....	25

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Pas dhënies së mendimit këshilldhënës nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) rreth aktit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 9 shtator 2010, miratoi rezolutën e sponsorizuar nga 27 vendet e atëhershme të Bashkimit Evropian dhe Serbia, e cila hapi rrugë për fillimin e dialogut Kosovë - Serbi, të lehtësuar nga BE.¹ Kjo rezolutë, e miratuar me konsensus nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, përshëndeste mendimin e GJND-së, si dhe e mirëpriste gatishmërinë e Bashkimit Evropian për të lehtësuar procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke theksuar se ky proces do të shërbente si faktor i paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon. Ky proces u tha se do të promovojë bashkëpunimin, përmirësoj jetën e qytetarëve dhe do t'i ndihmoj të dyja vendet të arrijnë progres në rrugën e tyre drejt Bashkimit Evropian.

Si rrjedhojë, me 10 mars 2011, Kuvendi i Kosovës miratoi një rezolutë e cila e mandatonte Qeverinë e Republikës së Kosovës për të nisur bisedimet teknike me Serbinë, si dhe i kërkonte asaj që të raportonte në baza të vazhdueshme për rrjedhën e procesit.² Përmes kësaj rezolute, Kuvendi i Republikës së Kosovës gjithashtu e obligoi ekzekutivin që t'ia paraqiste dokumentin themelor për dialogun brenda afateve ligjore, duke specifikuar parimet e përgjithshme të dialogut teknik, objektivat si dhe çështjet e panegociueshme. Krahas bisedimeve teknike, në fund të vitit 2012 filluan edhe bisedimet politike për normalizim të marrëdhënieve. Me 18 tetor 2012, Kuvendi i Kosovës miratoi një rezolutë të re përmes së cilës përkrahte fillimin e dialogut politik duke mandatuar sërish Qeverinë e Kosovës për të udhëhequr me këtë proces.³

Dialogu me Serbinë është karakterizuar nga ndërprerje dhe vonesa të kohë pas kohëshme, si pasojë e tensioneve, ofrtë të brendshme apo edhe ndërmjet dy vendeve. Në veçanti, zgjedhjet nacionale në të dy vendet gjatë viti 2014, shkaktuan vonesa të mëdha në zhvillimin e dialogut. Së fundmi, dialogu ishte pezulluar me anë të një rezolute të Kuvendit të Kosovës në mars të vitit 2017⁴, pas arrestimit të Ramush Haradinajt më 04 janar 2017 në Francë.

Deri më tani, janë arritura mbi 23 marrëveshje në nivelin teknik dhe politik. Shumica e këtyre marrëveshjeve kanë adresuar çështje me rëndësi për jetën e qytetarëve, të cilat kanë synuar shpërbërjen e strukturave paralele serbe në Kosovë, shtrirjen e shtetit ligjor në tërë territorin e vendit dhe konsolidimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës. Megjithatë, zbatimi i tyre nuk ka qenë i kënaqshëm duke u nisur dhe nga vet natyra e marrëveshjeve si dhe mosgatishmëria e palëve e veçanërisht e Serbisë për të respektuar marrëveshjet e arritura.

Procesi i dialogut është zhvilluar me kundërthënie të mëdha dhe polarizim të skenës politike. Mungesa e transparencës dhe llogaridhënies e kanë karakterizuar këtë proces që nga fillimi. Prandaj, së fundmi është artikuluar nevoja e një konsensusi të përgjithshëm politik mbi këtë çështje. Faza përmblyëse e dialogut pritet të kurorëzohet me arritjen e një marrëveshje ligjërish të obligueshme në mes palëve, ndërsa BE në strategjinë e fundit të Komisionit Evropian ka shprehur qartë se rruga drejtë BE-së për të dy palët lidhet me këtë proces.

1 Organizata e Kombeve të Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, "Rezoluta A/RES/64/298", 9 shtator 2010. I qasshëm në, http://www.un.org/en/ga/search/viee_doc.asp?symbol=A/RES/64/298

2 Kuvendi i Republikës së Kosovës, "Rezolutë për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë", 10 mars, 2011. I qasshëm në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezoluta_per_dialogun_midis_R.Kosoves_dhe_R.Serbise_2.pdf

3 Kuvendi i Republikës së Kosovës, Rezoluta "Për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë", 18 tetor 2012. I qasshëm në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezolute_Marredhenive_Kosova_Serbia.pdf

4 Kuvendi i Republikës së Kosovës, "Rezolutë lidhur me ndalimin e ish-kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në Francë", 10 mars 2017. I qasshëm në, http://kuvendikosoves.org/common/docs/2017_03_09_Rezoluta_nr_011_per_lirim_in_e_Ramush_Haradinaj.pdf



HYRJJE

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Serbia në vazhdimësi është angazhuar në mënyrë aktive për të penguar forcimin e brendshëm dhe konsolidimin e Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare. Një angazhim i tillë ishte edhe përpjekja e saj për kontestim të shpalljes së pavarësisë nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, gjë e cila u hodh poshtë. Megjithatë, opinioni i GJND-së hapi rrugë për nisjen e një procesi të ri të dialogimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që për qëllim kishte zgjidhjen e kontesteve bilaterale, gjë që do të qonte në normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve.

Qëllim i këtij punimi është të vlerësojë nëse dialogu me Serbinë i ka arritur objektivat e tij për shtrirjen e sovranitetit në të gjithë territorin e tij, forcimin e shtetësisë në arenën ndërkombëtare, si dhe integrimin e komunitetit serb në institucionet dhe jetën shoqërore të Kosovës. Poashtu, duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve dhe opinionit publik, ky punim ofron një sërë rekomandimesh për spektrin politik se si të veprohet më tutje.

I gjithë procesi i dialogut ka qenë i mbyllur duke e dëmtuar kështu kredibilitetin e tij. Mungesa e transparencës dhe llogaridhënies kanë ndikuar edhe në zbatimin e marrëveshjeve të arritura. Në të njejtën kohë, për shkak të mungesë së informacionit lidhur me rrjedhën e procesit, pakënaqësitë dhe kundërshtimet ndaj dialogut janë rritur me kalimit e kohës. Për më tepër, shtatë vite nga fillimi i dialogut, progresi i shënuar në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve është i vogël. Janë arritur një numër i konsiderueshëm i marrëveshjeve, por zbatimi i tyre ka qenë jo i kënaqshëm. Arsyet e moszbatimi të marrëveshjeve kanë qenë të ndryshme, duke filluar nga mungesa e vullnetit politik, e deri te konflikti i përmbajtjes së tyre me rendin kushtetues e juridik të Republikës së Kosovës. Në të njejtën kohë, Serbia ka vazhduar të llojë dhe pengojë konsolidimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Pavarësisht kësaj, dialogu me Serbinë tashmë është duke hyrë në fazën përfundimtare të tij. Shumë gjëra janë ende të paqarta, duke filluar nga përfaqësimi, formati, temat që do të diskutohen apo edhe epilogu i dialogut. Megjithatë, Bashkimi Europian e ka bërë të qartë se në një afat të shkurtër kohorë, pret arritjen e një marrëveshje ligjërish të obligueshme ndërmjet palëve, në mënyrë që tu hapet rrugë për avancim drejt anëtarësisimit në BE.



DIALOGU KOSOVË-SERBI

Dialogu gjatë qeverisë Thaçi II (2011 – 2014)

Rezoluta e OKB-së i dha fillësë procesit të dialogut Kosovë-Serbi dhe më 10 mars 2011, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Rezolutën përmes së cilës mbështeste "dialogun midis dy shteteve të pavarura dhe sovraane, Kosovës dhe Serbisë, për çështje praktike, në interes të përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe të avancimit të agjendës evropiane për të dy shtetet dhe për rajonin".⁵ Kjo Rezolutë gjithashtu e obligoi Qeverinë e Kosovës që t'ia paraqiste Kuvendit dokumentin themelor për dialogun brenda afateve ligjore dhe rikonfirmoi të drejtën e Kuvendit për të ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare.⁶

Takimi i parë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë u mbajtë me 9 mars 2011 në të cilin Republika e Kosovës përfaqësohej nga znj. Edita Tahiri, zëvendës kryeministre dhe ministre për dialogun në qeverinë e atëhershme të Republikës së Kosovës, ndërsa delegacioni serb udhëhoqej nga z.Borko Stefanovic, i emëruar special i qeverisë së Serbisë për dialog. Gjatë fazës së parë të dialogut,⁷ deri në fund të vitit 2012, u arritën 7 marrëveshje për: 1. lëvizjen e lirë, 2. marrëveshja për menaxhimin e integruar të kufirit/Marrëveshja e IBM-it, 3. regjistrat kadastral, 4. regjistrat civil, 5. përfaqësimin rajonal,

6. njohjen e diplomave, 7. marrëveshja për njohjen e ndërsjelltë të vulave doganore. Ndërsa, u inicuan diskutimet për çështjet lidhur me telekomunikacionin dhe energjinë.⁸

Megjithatë, meqë shumica e marrëveshjeve të arritura e tejkalojnë natyrën teknike dhe kanë më shumë konotacion politik, procesi që nisi si dialog teknik u pasua nga dialogu politik për normalizimin e marrëdhënieve.

Si rrjedhojë, më 18 tetor 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi një Rezolutë të re me anë të së cilës autorizoi Qeverinë e Republikës së Kosovës që të udhëhoq me procesin e dialogut politik, duke kërkuar pjesëmarrjen e Komisioneve parlamentare relevante.⁹ Ashtu si në Rezolutën e parë, edhe në këtë Rezolutë u tha se Qeveria e Kosovës e ka për obligim të raportojë në mënyrë të rregulltë mbi procesin e dialogut, duke theksuar se marrëveshjet e procesit të normalizimit do të ratifikohen nga Kuvendi. Në këtë Rezolutë, vërehet ndryshim i terminologjisë së përdorur ngase tashmë dialogu konsiderohet si proces për zgjidhjen e problemeve në mes dy shteteve të pavarura dhe sovraane. Gjithashtu, roli i SHBA-ve pëson ndryshim nga

⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës, "Rezolutë për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë", 10 mars, 2011. I qasshëm në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezoluta_per_dialogun_midis_R.Kosoves_dhe_R.Serbise_2.pdf

⁶ Po aty, Pika e pestë e Rezolutës.

⁷ Dialogu është zhvilluar në dy faza deri më tani (ndarje bazuar në Rezolutat e Kuvendit të Republikës së Kosovës)

⁸ Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ministria për Dialog, "Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Dialogun e Brukselit /periudha 2014 – 2018/", 15 janar 2015, fq. 6. I qasshëm në, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_i_Qeveris%C3%AB_s%C3%AB_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_per_Dialogun_e_Brukselit_-_periudha_2014-2018_-_150115.pdf

⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Rezoluta "Për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë", 18 tetor 2012. I qasshëm në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezolute_Marredhenive_Kosova_Serbia.pdf



lehtësues në mbështetës të fuqishëm të këtij procesi. Edhe kjo Rezolutë thekson që marrëveshjet duhet të jenë në pajtim me sovranitetin e Kosovës, subjektivitetin ndërkombëtar, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm rendin unik kushtetues të Kosovës.¹⁰

Më 19 tetor 2012, z. Hashim Thaçi në cilësinë e Kryeministrit të Kosovës u takua në Bruksel me Kryeministrin e Serbisë z. Ivica Dačić. Kështu dhe filloi dialogu politik i cili u quajt dialogu për normalizim, i udhëhequr nga krerët e ekzekutivit të të dyjave shteteve dhe i lehtësuar nga BE. Deklarata e lëshuar nga znj. Ashton, pas takimit të parë, nuk ofroi shumë detaje por vetëm u tha se takimi ishte mbajtur në frymë të mirë dhe konstruktive.¹¹

Pas 10 roundesh të takimeve në mes kryeministrave, më 19 prill 2013 znj. Ashton në një deklaratë njoftoi se të dy kryeministrat ishin dakorduar mbi tekstin e marrëveshjes së parë mbi parimet e përgjithshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e njohur ndryshe edhe si 'marrëveshja e Brukselit'. Ajo i uroi kryeministrat për kurajon e tyre duke e konsideruar këtë të arritur si një hap më afër Evropës.¹² Edhe Presidenti i Këshillit Evropian i asaj kohe z. Herman Van Rompuy uroi të dy kryeministrat duke e konsideruar këtë marrëveshje si historike dhe duke rikonfirmuar perspektivën evropiane për të dy vendet.¹³

Një ditë më pas, pas kthimit nga Brukseli, Kryeministri Thaçi mbajti një konferencë për medie në të cilën deklaroi se të gjitha palët kishin fituar dhe se me këtë marrëveshje do të normalizohej veriu, si dhe do të shtrihet sistemi kushtetues dhe ligjor i Kosovës në tërë vendin.¹⁴ Thaçi poashtu siguroi se kjo marrëveshje ishte në përputhje të plotë me kushtetutën e Kosovës dhe ligjet e vendit. Ndërsa për asociacionin e komunave me shumicë serbe tha se do të kishte të njëjtat kompetenca si asociacioni aktual i komunave në Kosovë. Ai e përmbylli adresimin e tij duke

shtuar se Kosova po hynte në epokën e normalitetit.¹⁵ Në fakt këto pritshmëri të pritura nga procesi i dialogut nuk arritën të përmbusheshin as pas 7 vite negociatash.

Më 22 prill 2013, Kuvendi i Kosovës kaloi një Rezolutë me anë të së cilës shprehu pëlqimin dhe përkrahjen për nënshkrimin e marrëveshjes së parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve, si dhe mbështetjen për zotimet e dala nga kjo marrëveshje.¹⁶ Kjo Marrëveshje më pas u ratifikua më 27 qershor 2013 në Kuvendin e Kosovës me votën e 2/3 të deputetëve si marrëveshje ndërkombëtare. Kjo është edhe marrëveshja e vetme e arritur në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi e cila u ratifikua në Kuvendin e Kosovës.¹⁷

Marrëveshja pesëmbëdhjetë pikëshe e 19 prillit 2013 në pjesën më të madhe të saj adreson integrimin e komunitetit serb veçanërisht komunave veriore të Kosovës në këmbim të krijimit të asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe, i cili sipas marrëveshjes ka kompetenca të plota në shumë fusha, përfshirë zhvillimin ekonomik, arsimin, shëndetësinë si dhe planifikimin urban dhe rura.¹⁸ Përveç kësaj, marrëveshja e Brukselit parashihte integrimin e pjesëtarëve të strukturave serbe të sigurisë në strukturat ekuivalente të Kosovës, mbajtjen e zgjedhjeve lokale në komunat e veriut për herë të parë që pas shpalljes së pavarësisë, financimin transparent nga ana e Serbisë, diskutimet për energjinë dhe telekomin si dhe mos pengimin e njëra-tjetrën drejtë rrugës për në BE.¹⁹

Marrëveshja e Brukselit gjithashtu precizon se do të ketë një komandant regjional të policisë për katër komunat me shumicë serbe, i cili do të jetë i nacionalitetit serb, si dhe parimet e përgjithshme për integrimin e autoriteteve gjyqësore paralele në kuadër të kornizës së sistemit juridik të Republikës së Kosovës.²⁰

10 Po aty.

11 Bashkimi Evropian, "Deklarata e Përfaqësueses së Lartë Catherine Ashton mbi vazhdimin e dialogut të lehtësuar nga BE", 19 tetor 2012. I qasshëm në, http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_Data/docs/pressdata/EN/foraff/133036.pdf

12 Bashkimi Evropian, "Vërejtjet nga Përfaqësuesja e Lartë Catherine Ashton mbi dialogun e lehtësuar nga BE", 19 prill 2013. I qasshëm në, http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/foraff/136875.pdf

13 Këshilli Evropian, "Deklaratë nga Presidenti i Këshillit Evropian Herman Van Rompuy, me rastin e marrëveshjes në kuadër të dialogut të lehtësuar mbi normalizimin e marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës", 19 prill, 2013. I qasshëm në, http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/ec/136877.pdf

14 Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, "Kryeministri Thaçi: Ka fituar opsioni i paqes, stabilitetit dhe integritetit", 20 prill 2013. I qasshëm në, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1.9.3499>

15 Po aty.

16 Kuvendi i Republikës së Kosovës, Rezoluta "Për dhënie dhe pëlqimit për nënshkrim të Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë", 21 prill, 2013. I qasshëm në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezoluta_per_marreveshje.pdf

17 Kuvendi i Republikës së Kosovës, "Ligji Nr. 04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës Së Serbisë", 27 qershor 2013. I qasshëm në, <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ratifikimin%20e%20marreveshjes%20se%20pare%20per%20normalizimin%20e%20marredhenjeve%20Kosove%20Serbi.pdf>

18 Po aty. Pika 4.

19 Po aty.

20 Po aty. Pika 9 dhe 10.



Kjo marrëveshje është konsideruar edhe si integrim i strukturave paralele në kornizën kushtetuese të Kosovës, në këmbim të influencës ligjore të qeverisë serbe në çështjet e brendshme të Kosovës ndërmjet Asociacionit/bashkësisë, i financuar në pjesë të madhe nga Beogradi²¹.

Kjo marrëveshje ngjalli reagime dhe kundërshtime të shumta në Kosovë, për shkak të përmbajtjes së saj. Një pjesë e opozitës së atëhershme pretendonte se kjo marrëveshje dhe plani për zbatimin e saj, e deunkfionalizojnë shtetin e Kosovës dhe krijojnë një entitet autonom serb në veri²². Prandaj, në korrik të vitit 2013, Lëvizja Vetëvendosje, e cila kundërshtonte ashpër marrëveshjen, e dërgoi atë në Gjykatën Kushtetuese për të kërkuar vlerësimin e kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë së ligjit për ratifikimin e kësaj marrëveshje.²³ Gjykata Kushtetuese refuzoi interpretimin e marrëveshjes së 19 Prillit me arsyetimin se vlerësimi i kësaj marrëveshjes dhe planit të zbatimit "bie jashtë fushëveprimit të juridiksionit racione materiae të gjykatës".²⁴

Entuziazmi mbi të arriturat që marrëveshja 'historike' do të sillte në shpërbërjen e strukturave paralele, në uljen e ndikimit të Serbisë në Kosovë, në integrimin e komunave veriore në sistemin kushtetues dhe ligjor të Kosovës, do të zbehej me mungesën e zbatimit të marrëveshjeve nga palët. Vitet 2013 dhe 2014 do ta kthenin largonin dialogun nga epiqendra e politikës për shkak të largimit nga posti i saj i sekretarës së shtetit të SHBA-së znj. Clinton, zgjedhjeve në Bashimin Evropian, pas të cilave Federica Mogherini zëvendësoi baroneshën Ashton në pozitën e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë dhe Zv. Presidente e Komisionit Evropian dhe zgjedhjeve të parakohshme në Kosovë dhe në Serbi.²⁵



Marrëveshja e Brukselit gjithashtu precizon se do të ketë një komandant regional të policisë për katër komunat me shumicë serbe, i cili do të jetë i nacionalitetit serb, si dhe parimet e përgjithshme për integrimin e autoriteteve gjyqësore paralele në kuadër të kornizës së sistemit juridik të Republikës së Kosovës. ■■

21

22 Radio Evropa e Lirë, "Vetëvendosje me demonstrata kundër ratifikimit të marrëveshjes", 29 maj 2013, e qasshme në <https://www.evropaelire.org/a/25000854.html>

23 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktigjykim në rastin nr. KO95/13, 9 shtator 2013, e qasshme në http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ko_95_13_shq.pdf

24 Po aty, fq. 23.

25 David L. Phillips, Director of the Program on Peace-building and Rights Institute for the Study of Human Rights Columbia University, "Implementation Review of the Kosovo-Serbia Dialogue", 5 shtator 2017, fq. 8 dhe 9. I qasshëm në http://www.humanrightscolumbia.org/sites/default/files/2017_09_05_kosovo-serbia_report.pdf

Dialogu gjatë qeverisë Mustafa (2014 – 2017)

Më 25 gusht 2015, një infuzion i ri u tentua t'i jepej dialogut Kosovë-Serbi, kur kryeministri i Republikës së Kosovës, Isa Mustafa dhe ai i Serbisë, Aleksandar Vucic, pas një sërë takimesh arritën paketën e Marrëveshjeve të Brukselit, në të cilën u përfshinë: marrëveshja për energjinë, telekomunikacionin, themelimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe si dhe lëvizjes së lirë/Urës së Mitrovicës. Ky takim u cilësua nga znj. Federica Mogherini si kthesë për avansimin e agjendës së dialogut Kosovë-Serbi duke shënuar një të arritur të madhe në procesin e normalizimit.²⁶ Rëndësi e veçantë iu kushtua edhe marrëveshjes mbi parimet për asociacionin e komunave me shumicë serbe me anë të së cilës u tha që i hap rrugë edhe themelimit të tij.²⁷

Pala kosovare deklaroi se asociacioni do të kishte kompetenca të një OJQ-je, ndërsa pala serbe deklaroi se asociacioni/bashkësia e komunave me shumicë serbe do të ketë kompetenca ekzekutive.²⁸ Marrëveshja e arritur në mes palëve rreth Asociacionit të komunave me shumicë serbe u kundërshtua ashpër nga opozita dhe shoqëria civile në Kosovë për shkak të kompetenca të cilat do ti kishte ky Asociacion. KDI deklaroi në atë kohë se kjo marrëveshje si e tillë "shkon përtej lirisë së asociimit sipas rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Ky Asociacion/Bashkësi nuk përbën një organizatë jo-qeveritare (OJQ) siç ishte paralajmëruar por qon në një nivel të tretë qeverisës.²⁹

Mjetet e përdorura për kundërshtimin e kësaj marrëveshje, si gazi lotësjiellës i cili u hodh nga partitë opozitare në Kuvend, protestat masive si dhe 200 mijë nënshkrimet e

mbledhura nga qytetarët në peticion kundër asociacionit dhe demarkacionit³⁰, polarizuan tejskajshëm skenën politike, kundërshtim i cili paralizoi funksionimin normal të Kuvendit. Kjo situatë dëmtoi besueshmërinë në marrëveshjet të cilat ishin duke u arritur në kuadër të këtij procesi si dhe vet procesin e dialogut.

Në kërkim të zgjidhjes për të tejkaluar krizën politike të krijuar në vend, presidentja e atëhershme e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, më 30 tetor 2015 iu drejtua Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për interpretimin e përputhshmërisë së parimeve të asociacionit me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në aktgjykimin e saj të datës 23 dhjetor 2015, Gjykata Kushtetuese konstatoi se parimet, siç janë elaboruar në "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosove-Parimet e pergjithshme/Elementet kryesore", nuk janë tërësisht në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës, duke kërkuar që vendimet lidhur me bashkësinë/asociacionin, statuti dhe akti ligjor shoqërues nga qeveria, të jenë në përputhje të plotë me Kushtetutën.³¹

Dinamika e bisedimeve u ngadalësua ndjeshëm pas verës së vitit 2015, ndër të tjera edhe për shkak të situatës politike në Kosovë³². Takimet që u mbajtën në mes palëve nën ndërmjetësimin e BE-së edhe gjatë vitit 2016 kishin frymën e shprehjes së gatishmërisë për zbatimin e marrëveshjeve në takimet formale me znj. Mogherini. Këto takime shërbyen për arritjen e dakordësimeve rreth planeve të zbatimit për marrëveshjet që lidheshin me marrëveshjen e prillit, si dhe përcaktimin e afateve kohore për zbatim³³. Pavarësisht kësaj,

²⁶ Bashkimi Evropian, "Deklaratë nga Përfaqësuesja e Lartë / Zvendës - Presidentja Federica Mogherini pas takimit të dialogut të lehtësuar nga BE", 25 gusht 2015. I qasshëm në, https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/3182/statement-by-high-representativevice-president-federica-mogherini-follo%C3%ABing-the-meeting-of-the-eu-facilitated-dialogue_en

²⁷ Po aty.

²⁸ BIRN, Bodo Weber, DPC, "BIG DEAL: TRUKU I NGATHTË: Pasiguria Kushtetuese, Jostabiliteti Politik dhe Sundimi i ligjit në Dialogun Kosovë-Serbi", 2016. I qasshëm në, <http://prishtinainsight.com/wp-content/uploads/2016/04/BIRN-Report-2016-SHQIP.pdf>

²⁹ Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), "Marrëveshja nuk krijon një OJQ por qon në nivel të tretë qeverisës", 26 gusht, 2015. I qasshëm në, <http://kdi-kosova.org/aktivitetet/marreveshja-nuk-krijon-nje-ojq-por-qon-ne-nivel-te-trete-qeverises/>

³⁰ Portali Telegrafi, "200 mijë nënshkrime në peticionin kundër Asociacionit dhe demarkacionit (Video)", 20 tetor, 2015. I qasshëm në, <https://telegafi.com/200-mije-nenshkrime-ne-peticionin-kunder-asociacionit-dhe-demarkacionit-video/>

³¹ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, konstatoi në AKTGJYKIMIN në Rastin nr. K0130/15 se: "Parimet, siç janë elaboruar në "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosove-Parimet e pergjithshme/Elementet kryesore", nuk janë tërësisht në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 ëBarazia para Ligjitç, paragrafi 1, me Kapitullin II ëTe Drejtat dhe Lirite Themeloreç dhe me Kapitullin III ëTe Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesetareve te tyreç te Kushtetutes se Republikes se Kosoves;", 23 dhjetor 2015. I qasshëm në, http://www.votaim.org/Uploads/Data/Documents/VLERES-1_GmystyF653.PDF

³² Kosova në vitin 2015, më shumë informacione në <https://www.zeriamerikes.com/a/kosova-ne-vitin-2015-/3123197.html>

³³ Për më shumë informacione mbi këto takime, http://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/9823/eu-facilitated-dialogue-implementation-of-the-freedom-of-movement-agreement_en



Dialogu në përgjithësi pësoi goditje të mëdha veçanërisht me angazhimin e diplomacisë serbe kundër njohjes së shtetit të Kosovës apo anëtarësimin e saj në organizata ndërkombëtare si **UNESCO** dhe **INTERPOL**, si dhe murin e ndërtuar në urën e Mitrovicës në një kohë kur pritej dhe hapja e kësaj ure. ▮▮

trendi i mos respektimit të afateve kohore të dakordësuara vazhdoi edhe më tej. Takimet e nivelit teknik vazhduan të mbaheshin ndërmjet palëve, nën lehtësimin e BE-së, por mosrespektimi i afateve kohore të dakorduara, u kthye në normë të dialogut.

Dialogu në përgjithësi pësoi goditje të mëdha veçanërisht me angazhimin e diplomacisë serbe kundër njohjes së shtetit të Kosovës apo anëtarësimin e saj në organizata ndërkombëtare si UNESCO dhe INTERPOL, si dhe murin e ndërtuar në urën e Mitrovicës në një kohë kur pritej dhe hapja e kësaj ure.

Poashtu, riaktivizimi i arresteve ndërkombëtare nga ana e Serbisë ndaj qytetarëve dhe zyrtarëve të lartë të Kosovës, tensionoi raportet ndërmjet dy palëve, duke çuar në pezullimin e dialogut nga ana e Kosovës. Të gjitha këto ngjarje dëmtuan frymën konstruktive në mes palëve dhe vet qëllimin e këtij dialogu. Situata u acarua skajshëm në janar 2017, me dërgimin e trenit ilegal nga ana e Serbisë me ikonografi fetare dhe shënime 'Kosova është Serbi'.³⁴

Ky provokim solli ndërhyrjen e Brukselit zyrtar me qëllim të zbutjes së tensioneve. znj. Mogherini duke tentuar relaksim në situatës së krijuar ftoi të dy palët në një takim në Bruksel, të cilat në përbërje të tyre do të kishin Kryeministrat

dhe Presidentet e të dy vendeve, nga i cili takim u deklarua se palët ishin dakorduar të linin tensionet prapa dhe të ecnin përpara. Znj. Mogherini në këtë takim kishte theksuar se progresi në normalizimin e marrëdhënieve ishte esencial duke lavdëruar lidhshimin, vizionin dhe përkushtimin e liderëve për ta shtyrë përpara dialogun, që pritej të kishte takime të reja të nivelit të lartë.³⁵

Por situata e tensionuar në mes palëve nuk arriti të qetësonte palët, në mars të vitit 2017, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi një rezolutë e cila kërkonte pezullimin e procesit të dialogut deri në lirimin e kryeministrit aktual të Kosovës, z. Ramush Haradinaj, i cili ishte ndaluar në Francë në bazë të një urdhërarrestit të lëshuar nga Serbia.³⁶ Ndërsa partitë politike filluan të artikulonin nevojën për ndryshimin e qasjes në dialog, duke kërkuar riformatimin e këtij procesi dhe konsensus të gjerë politik³⁷. Pas kësaj Rezolute, Kuvendi i Kosovës shkoi në zgjedhje të reja dhe deri në formimin e Qeverisë së re nuk u mbajt asnjë takim në mes Kryeministrave të dy vendeve.

³⁴ Dërgimi i trenit me ikonografi kishtarë dhe shënimin 'Kosova është Serbi' për të hyrë ilegalisht në Kosovë, avaroi raportet në mes palëve ku ndërhyrja e BE-së u konsiderua si e rëndësishme për relaksim në situatës.

³⁵ Bashkimi Evropian, "Deklarata e Federica Mogherinit pas takimit të nivelit të lartë në kuadrin e Dialogut të ndërmjetësuar nga BE ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës", 24 janar 2017. I qasshëm në, https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/19150/federica-mogherinis-statement-fol-lowing-high-level-meeting-framework-eu-facilitated-dialogue_en

³⁶ Kuvendi i Republikës së Kosovës, "Rezolutë lidhur me ndalimin e ish-kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në Francë", 10 mars 2017. I qasshëm në, http://kuvendikosoves.org/common/docs/2017_03_09_Rezoluta_nr_011_per_lirimin_e_Ramush_Haradinaj.pdf

³⁷ Tryezë e organizuar nga KDI ku partitë politike diskutuan rrugën përpara dhe artikuluan qëndrimin për ndryshimin e qasjes së dialogut dhe ndërlihdjen e këtij procesi me rrugëtimin e Kosovës drejtë BE-së, për më shumë informacioni klikoni në <http://votaimo.org/Public/DialogActivity/Detail/87>



Dialogu gjatë qeverisë Haradinaj (2017 - ...)

Takimet në Bruksel u rikthyen me 3 korrik 2017, kur presidentët e Kosovës dhe Serbisë, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiç, u takuan për tu dakorduar që dialogu të hyjë në një fazë të re, ku do të diskutoheshin çështje më me peshë dhe do të shkohej drejt përmblylljes së këtij procesi.³⁸ Më tej, në gusht 2017, Presidentët u takuan sërish dhe u dakorduan për zbatimin e marrëveshjes së drejtësisë, duke përcaktuar datën 17 tetor si ditë për fillimin e zbatimit të saj.³⁹

Dialogu vazhdoi të zhvillohet në nivel të Presidentëve nën lehtësimin e BE-së, duke u paralajmëruar faza e re përmblyllëse e dialogut, e cila pritet të finalizohet me arritjen e një marrëveshje ligjërish të obligueshme.

Partitë opozitare, në mënyrë të vazhdueshme, kanë shprehur pakënaqësinë e tyre për udhëheqjen e dialogut nga ana e Presidentit të vendit, duke argumentuar që i njëjti nuk ka mandatin e Kuvendit⁴⁰ dhe duke theksuar nevojën për nxjerrjen e një Rezolute të re nga ana e Kuvendit. Megjithatë, legjislatura e VI ende nuk ka mbajtur asnjë seancë plenare që nga konstituti i saj, në të cilën do të diskutohej rreth dialogut Kosovë-Serbi dhe do të kërkohet kalimi i një Rezolute të re, për fazën e ardhshme të dialogut. Megjithëse presidenti Thaçi pati deklaruar nevojën për një ekip uniteti, ende nuk ka marr asnjë hap konkret në këtë drejtim.⁴¹ Në anën tjetër, Presidenti serb Vuçiç ka filluar në Serbi një dialog të brendshëm për zgjidhjen e çështjes së Kosovës.

Në Qeverinë aktuale të udhëhequr nga z. Ramush Haradinaj, lider i AAK-së në vazhdimësi ka kërkuar ndryshimin e qasjes së dialogut, transparencë të plotë dhe njohjen e ndërsjelltë si epilogun e vetëm për këtë proces.⁴² Megjithatë pavarësisht kësaj, me vendim të Qeverisë më 12 janar 2018 në bazë të kërkesës së BE-së, Kryeministri Haradinaj emëroi shefin e stafit të tij z. Avni Arifi si shef të negociatave me Serbinë.⁴³ Kryeministri Haradinaj në një mbledhje të Qeverisë argumentoi se "dialogu politik përfaqësohet nga Presidenti Hashim Thaçi, ndërsa shefi i negociatave do të jetë në gjendje të përcjell rrjedhën me vendimarrësit politik."⁴⁴

Më 15 janar 2018, BE ftoi palët për të vazhduar dialogun teknik dhe për të diskutuar për zbatimin e marrëveshjeve të arritura. Ndërsa pala kosovare filloi takimet me zyrtarët e lartë⁴⁵ në po të njëjtën ditë, në Mitrovicë të veriut u vra liderit serb i partisë SDP, Oliver Ivanović. Pala serbe u tërhoq nga bisedimet duke kërcënuar me moskthim në dialog deri në zbardhjen e kësaj çështjeje.

Palët u rikthyen në tavolinën e diskutimit pas ftesës së BE-së për vazhdimin e këtij procesi më 26 dhe 27 shkurt 2018, ku diskutuan për zbatimin e marrëveshjeve të arritura si marrëveshja për lirinë e lëvizjes, menaxhimin e integruar të kufirit, asociacioni i komunave me shumicë serbe, drejtësia, energjia, dhe ura e Mitrovicës. Palët u dakorduan për vazhdim të këtyre takimeve muajin pasardhës. Po ashtu u dakorduan që pas këtij takimi të mos kishte prononcim të tyre, por vetëm një deklaratë zyrtare të BE-së mbi mbarëvajtjen e këtij procesi.⁴⁶

38 Bashkimi Evropian, "Federica Mogherini takohet me Presidentin Vuçiç të Serbisë dhe Thaçi të Kosovës", 3 korrik 2017. I qasshëm në, <https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/29156/federica-mogherini-meets-president-vucic-serbia-and-thaci-kosovo-en>

39 Bashkimi Evropian, "Federica Mogherini takohet me Presidentin Thaçi të Kosovës dhe Vuçiçin e Serbisë", 31 gusht, 2017. I qasshëm në, <https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/31526/federica-mogherini-meets-president-thaci-kosovo-and-vucic-serbia-en>

40 Portali INSAJDERI, "Vjosa Osmani thotë se Presidenti Thaçi duhet të jap llogari për Dialogun me Serbinë", 2 mars 2018. I qasshëm në, <http://www.insajderi.com/vjosa-osmani-thote-se-presidenti-thaci-duhet-te-jap-llogari-per-dialogun-serbine/>

41 KDI, "Në tryezën e KDI-së, Presidenti Thaçi bën thirrje për konsensus nacional për të përmblyllur dialogun Kosovë-Serbi", 14 shtator 2017. I qasshëm në, <http://votaim.org/Public/DialogActivity/Detail/130>

42 Kuvendi i Republikës së Kosovës, Transkripti i seancës së Kuvendit, 17 dhjetor 2017, fq.41. I qasshëm në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2017_12_14_10_7135_al.pdf

43 Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Vendimi i Qeverisë, Nr. 12/24, miratuar më 12 janar, 2018. I qasshëm në, www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_së_24-të_të_Qeverisë_së_Republikës_së_Kosovës_2018.pdf

44 Radio Evropa e Lirë, "Avni Arifi emërohet përfaqësues i Qeverisë së Kosovës në dialog me Serbinë", 12 janar 2018. I qasshëm në, <https://www.evropaelire.org/a/28971350.html>

45 Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, "Ekipi negociator i Kosovës për dialogun me Serbinë nis serinë e takimeve në Bruksel", 15 janar 2018. I qasshëm në, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,7485>

46 Bashkimi Evropian, "Deklarata e zëdhënësit pas takimit punues në kuadër të Dialogut të lehtësuar nga BE", 27 shkurt 2018. I qasshëm në, <https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/40471/statement-spokesperson-folloëing-örking-level-meeting-eithin-eu-facilitated-dialogue-en>

PLATFORMAT E QEVERISË PËR DIALOGUN KOSOVË-SERBI

Dokumenti 'Platforma e qeverisë së Republikës së Kosovës për dialogun teknik ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë' mban datën e mars 2011 me anë të së cilit përcaktohen korniza parimore, agjenda, objektivat dhe ekipi i dialogut. Në këtë dokument ofrohen argumente mbi dialogun si mjet për fuqizimin ndërkombëtar të Kosovës.

Elemente të rëndësishme si: i) sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm, ii) rregullimi i brendshëm i vendit është kompetencë sovrane e institucioneve shtetërore dhe se iii) Plani i Ahtisarit për rregullimin e të drejtave dhe garancive për komunitete - parashtrohen si parime të panegociueshme.⁴⁷ Këto koncepte vlen të nënvizohen pasi jo rrallë herë është pretenduar se dialogu ka sjell në tavolinën e negociatave çështje të brendshme të Kosovës duke shkuar përtej Planit të Ahtisaarit.

Në dokumentin zyrtar të Qeverisë së Kosovës rreth strategjisë së dialogut, marrëveshjet e arritura janë cilësuar që rrjedhin në formën e piramidës, ku palët nën ndërmjetësimin e BE-së kanë arritur marrëveshjet bazë dhe më pas janë dakorduar për planet e zbatimit, ndërsa në faza të tjera kanë arritur dhe marrëveshje për nën çështje të cilat kanë derivuar nga marrëveshjet bazë.

Qeveria e Kosovës ka publikuar edhe një dokument i ashtuquajtur Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Dialogun e Brukselit /periodha 2014 – 2018/, i ish ministres për dialog Edita Tahiri. Ky dokument që mban datën 15 janar 2015 paraqet dobitë e Kosovës nga Dialogu, qëllimin për njohjen e ndërsjellë, parimet e panegociueshme/vijat e kuqe, shtyllat e procesit negociator si dhe transparencën dhe llogaridhënien.⁴⁸ Në të thuhet ndër të tjera se një nga parimet themelore është mosndërhyrja në sovranitetin e njëra-tjetres dhe zhbërja e plotë e gjithë strukturave të mbetura paralele /ilegale të Serbisë në Kosovë. Poashtu, përmendet edhe zgjidhja e çështjeve të reparacioneve të luftës dhe suksesionit në bazë të drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, deri më tani strukturat paralele të Serbisë ende nuk janë shpërbërë dhe çështja e reparacioneve dhe suksesionit ende nuk janë diskutuar në kuadër të dialogut.

⁴⁷ Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, "Platforma e Qeverisë së Republikës së Kosovës për Dialogun Teknik Ndërshtetëror Midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë", mars 2011. I qasshëm në, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Platforma_e_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_per_dialogun_teknik_ndershtetor_midis_Republikes_se_Kosoves_dhe_Republikes_se_Serbise.pdf

⁴⁸ Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, "Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Dialogun e Brukselit /periodha 2014 – 2018/ ", 15 janar 2015. I qasshëm në, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_i_Qeveris%C3%AB_s%C3%AB_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_per_Dialogun_e_Brukselit_-_periodha_2014-2018_-_150115.pdf



ZBATIMI I MARRËVESHJEVE DHE DYKUPTIMËSIA KONSTRUKTIVE

Dykuptimësia konstruktive ose ambiguiteti konstruktiv është elementi që ka karakterizuar këto marrëveshje, metodë kjo për t'iu përshtatur qëndrimin të palëve rreth statusit të Kosovës. Ky term i vendosur nga ish sekretari i shtetit të SHBA-ve z. Henry Kissinger në vitet e 70ta është metodë e të negociuarit e cila bazohet në besimin që teksti i paqartë mund të krijojë hapësirë apo mundësi për avansimin e interesit të palëve. Kjo metodë u përdor në marrëveshjen e Oslo-së, në mes Izraelit dhe Palestinës, e cila është argumentuar të prodhojë konfuzion duke mos kontribuar në ndërtimin e besimit në mes palëve.⁴⁹

Edhe në procesin e dialogut Kosovë- Serbi, dykuptimësia konstruktive ofroi hapësirë për palët të interpretojnë marrëveshjet sipas verzionit të tyre dhe që të dy palët të shpallnin fitoret në bisedime. Rezolutati ishte konfuzion rreth çfarë është dakordësuar dhe çfarë në fakt është arritur në kuadër të këtij procesit. Për të evituar interpretimet e shpeshta, BE si ndërmjetësuese e këtij procesi me dakordimin e palëve vendosi të njoftonte zyrtarisht opinionin publik për takimet e mbajtura por jo dhe të interpretonte marrëveshjet e arritura duke mos kontribuar dukshëm në uljen e paqartësive por në fakt duke kontribuar më tej në uljen e transparencës së vet procesit.

Kjo mënyrë e marrëveshje - bërjes u përkthye në problematik në fazën e zbatimit të tyre. Por ky është vetëm një ndër

elementet që u ndërlidh me zbatimin e marrëveshjeve. Ishin vet palët e veçanërisht pala serbe ajo që nuk respektoi marrëveshjet e arritura duke mos përjashtuar këtu edhe vonesat nga pala kosovare.

Marrëveshjet e dialogut në përgjithësi janë karakterizuar nga zbatimi i dobët, ku afatet kohore të përcaktuara jo rrallë herë janë neglizhuar nga të dy palët. Kjo si pasojë ka stërzgatur procesin e zbatimit të tyre, duke i rikthyer në tryezën e diskutimit, ku ato janë rinegociuar nga delegacionet dhe afate të reja kohore të zbatimit janë përcaktuar, afate të cilat jo rrallë herë nuk janë respektuar. Kjo ka bërë që efektet në jetën e qytetarëve të jenë të paqarta.

Marrëveshjet e caktuara kanë gjetur përdorimin edhe jashtë qëllimit fillestar si ajo e fusnotës, marrëveshje e cila kishte për synim tejkalimin e bllokadave nga Serbia për përfaqësimin rajonal të Kosovës.⁵⁰ Kjo marrëveshje tashmë është bërë formë e përfaqësimit të Kosovës qoftë në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit apo dhe në ndarjen e kodit telefonik nga ITU.

Për këtë arsye, me 30 mars, 2017 Kuvendi i Kosovës pati miratuar një deklaratë me anë të të cilës e njihte Kosovën vetëm në bazë të emrit të saj kushtetues si Republikë e Kosovës, dhe e cila do t'i bashkëngjitej secilës marrëveshje ndërkombëtare, e cila ratifikohet në Kuvend nga ajo ditë e

49 BROOKINGS, OP-ED: "When Ambiguity is Destructive", Khaled Elgindy, 22 janar, 2014. I qasshëm në, <https://www.brookings.edu/opinions/ëhen-ambiguity-is-destructive/>

50 Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Marrëveshja për Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal, 24 shkurt 2012. I qasshëm në, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,191>





Shteti i Kosovës nuk ka arritur të vendos të gjitha institucionet për shkak të kërcënimeve dhe funksionalizimi i këtyre institucioneve ende nuk është bërë. ■■

tutje, përfshirë këtu edhe dokumenteve që nënshkruhen në mes palës së Kosovës dhe BE-së.⁵¹

Patjetër që përballë realitetit të boshllëkut institucional dhe mos shtritjes së shtetit në veri të Kosovës ka bërë që një pjesë e marrëveshjeve të mos arrijnë të zbatohen për shkak të rezistencës dhe mungesës së sigurisë siç është marrëveshja për shpërbërjen e strukturave paralele. Shteti i Kosovës nuk ka arritur të vendos të gjitha institucionet për shkak të kërcënimeve dhe funksionalizimi i këtyre institucioneve ende nuk është bërë.⁵²

Këto marrëveshje pavarësisht parimeve të darkodësuar me anë të Rezolutave kanë prekur rregullimin e brendshëm të Kosovës duke çenuar dhe frymën e shtetit qytetar dhe multietnik të Kosovës, siç është marrëveshje për asociacionin e komunave me shumicë serbe apo dhe marrëveshja për drejtësinë një marrëveshje tejte kontraverse e cila ende mbetet e papublikuar dhe detajet e zbatimit të kësaj marrëveshjeje mbeten të fshehura.

Jo rrallë herë bllokadat në zbatimin e marrëveshjeve kanë sjell dhe kosto të larta financiare siç është rasti i interkoneksionit në mes Kosovës dhe Shqipërisë⁵³, i cili ka mbetur pa u funksionalizuar për shkak të mungesës së gatishmërisë së Serbisë për të zbatuar marrëveshjen për energjinë, duke e bllokuar kështu pavarësimin e Kosovës në këtë sektor⁵⁴.

Parimi i reciprocitetit ka munguar në zbatimin e marrëveshjeve siç ka ndodhur me marrëveshjen për targa ku pala Serbe i ka detyruar vozitësit nga Kosova përdorimin e targave proba ndërsa Kosova nuk e ka kërkuar një gjë të tillë nga vozitësit me targa të Serbisë apo me njohjen e dokumenteve shtetërore dhe udhëtimin e shtetasve të huaj nëpërmjet pikave kufitare në mes Kosovës dhe Serbisë.

Përkundër numrit të madh të marrëveshjeve që janë arritur në kuadër të këtij procesi, vetëm një marrëveshje është miratuar në Kuvendin e Kosovës përkatësisht marrëveshja e Parë e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve. Kjo marrëveshje u parafua nga dy Kryeministrit më 19 prill 2013, u miratua nga Qeveria e Kosovës dhe u aprovua në Kuvendin e Kosovës më 22 prill 2013. Duke u kthyer në ligj më 27 qershor 2013.

Jo rrallë herë u argumentua që marrëveshjet të cilat më pas u arritën në fushat të cilat u dakorduan me marrëveshjen e Brukselit ishin derivat i kësaj marrëveshjeje, ndonëse ekspertët të të drejtës ndërkombëtare kanë argumentuar që marrëveshjet të cilat kanë elemente të reja janë marrëveshje të reja dhe duhet të konsiderohen si të tilla.⁵⁵

Ndërsa dialogu pritet të ec përpara në fazën e ardhshme, mungon një pasqyrë e qartë e fazës së zbatimit të marrëveshjeve, ku qëndrojnë sfidat dhe problematikat, mungon skanimi i marrëveshjeve të arritura si dhe reflektim mbi tërë procesin i cili do të shërbente për hapat e mëtejme të dialogut.

51 Kuvendi i Republikës së Kosovës, Deklaratë, 30 mars 2017, fq.30. I qasshëm në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2017_03_30_10_6926_al.pdf

52 Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, "Qeveria e Kosovës ka kërkuar nga Bashkimi Evropian që të ndalen destruksionet e Serbisë ndaj marrëveshjeve të Brukselit", 29 dhjetor, 2017. I qasshëm në, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,6459>

53 Letër e drejtuar nga ish Ministria e Dialogut znj. Edita Tahiri, Ministri të Energjisë së Republikës së Shqipërisë z. Gjijnuri mbi moszbatimin e Marrëveshjes së Energjisë, për më shumë informacione klikoni në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Leter_nga_Ministrja_Tahiri_per_Ministrin_Gjijnuri_1111016.pdf

54 Po aty

55 Hulumtim Parlamentar i përgatitur nga Kushtrim Istrefi, për Komisionin për Integritet të Kuvendit të Kosovës, "Roli i Kuvendit në Dialogun Kosovë-Serbi dhe Rrugëtimi drejt BE-së", tetor 2017.



NIVEL TEKNIK



Robert Cooper

Edita Tahiri Borko Stefanovic

NIVEL POLITIK



Catherine Ashton

Hashim Thaçi Ivica Dacic

2011

2012

2013

2014

09 SHTATOR
Rezoluta Nr. 64/298
e samlesë së
Përgjithshme të OKB-së*

MARRËVESHJET
E ARRITURA



08-09 MARS
Takimi i Parë i
dialogut teknik

2 KORRIK

Marrëveshja për lirinë e
lëvizjes

1

2 Marrëveshja për regjistrat civil

Marrëveshja për Pranimin e

Diplomave Universitare (1)

3

2 SHTATOR

Marrëveshja për vulat
doganore

1

Marrëveshja për regjistrat
kadastral

2

21 NENTOR

Marrëveshja për Pranimin e
Diplomave Universitare (2)

1

2 DHJETOR

Marrëveshja për menaxhimin
e integruar të kufirit

1

MARRËVESHJET
E ARRITURA



24 SHKURT

Marrëveshja për
përfaqësim rajonal
dhe bashkëpunim

1

19 TETOR

Marrëveshja për
zyrtarët ndërlidhës

1

2012

19 TETOR
Takimi i parë
i dialogut
politik



7 NËNTOR

Marrëveshja
për autostradën
Prishtinë-Nishë

1

4 DHJETOR

Marrëveshja
për zyrtarët
ndërlidhës

1

2012

MARRËVESHJET
E ARRITURA



17 JANAR

Marrëveshja e Brukselit
për Mbledhjen e të
Hyrave Doganore

1

17 PRILL

Marrëveshja për drejtësi

1

19 PRILL

MARRËVESHJA E PARË E
PARIMEVE QË RREGULLOJNË
NORMALIZIMIN E RAPORTEVE
(MARRËVESHJA E
BRUKSELIT)

1

21-22 MAJ

Plani implementues për
Marrëveshjen e Brukselit

1

30 MAJ

Marrëveshja për Zyrtarët Ndërlidhës
(Konkluzionet e Kryesuesit)

1

8 SHTATOR

Marrëveshja për Telekomunikacion

1

Marrëveshja për Energjinë

2

7 TETOR

Marrëveshja për vizitat e zyrtare

1

MARRËVESHJET
E ARRITURA



KORRIK 2014

Dialogu
teknik



Edita Tahiri



Marko Djuric

14 NËNTOR

1

Aranzhimet për
vizita zyrtare

DIALOGU KOSOVË-SERBI



NIVEL POLITIK

Federica Mogherini



Isa Mustafa Aleksandar Vucic



NIVEL POLITIK

Federica Mogherini



Hashim Thaçi Aleksandar Vucic

2015

2016

2017

2018

MARRËVESHJET
E ARRITURA



MARRËVESHJET
E ARRITURA



MARRËVESHJET
E ARRITURA



MARRËVESHJET
E ARRITURA



09-10 SHKURT
Dialogu politik

3 KORRIK
Dialogu politik

JANAR 2018

Dialogu teknik



Avni Arifi



Marko Djuric

1 10 SHKURT
Marrëveshja për Drejtësi dhe Gjyqësorin (finalizimi)

1 26 MARS
Marrëveshja për shpërbërjen e të ashtuquajturës 'mbrojtja civile'

1 25 QERSHOR
Marrëveshja për njohjen reciproke të policave (sigurimeve) të automjeteve

1 25 GUSHT
Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë – Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore
2 Konkluzionet për zbatimin e Marrëveshjes për Energjinë të vitit 2013

3 Plani i veprimit i telekomunikacionit

4 Marrëveshja për Lirinë e Lëvizjes/ Konkluzionet për Urën e Mitrovicës

1 15 TETOR
Marrëveshja për telekomunikacionit plani i përditësuar i veprimit

1 19 JANAR
Marrëveshja për njohjen reciproke të diplomave të bazuar në marrëveshjet origjinale të vitit 2011

1 4 PRILL
Plani për Zbatim i marrëveshjes për njohjen reciproke të diplomave

1 19 PRILL
Marrëveshja e Brukselit për njohjen reciproke të certifikatave ADR

1 8 GUSHT
Marrëveshja për Urën e Mitrovicës Plani i BE-së për implementim

1 14 SHTATOR
Aranzhimet lidhur me finalizimin e zbatimit të marrëveshjes për lëvizjen e lirë të vitit 2011

1 Dakordim për vazhdimin e dialogut dhe hyrjen në një fazë të re

2 31 GUSHT
Dakordimi për zbatimin e marrëveshjes për drejtësinë

15 JANAR

1 Diskutimi për energjinë, lirinë e lëvizjes, bashkëpunimin rajonal. Diskutimet u ndërpren pas vrasjes së Oliver Ivanovici

25 SHKURT

2 Diskutim mbi implementimin e deritanishem te marreveshjeve

19 MARS

3 Diskutim për marrëveshjen e asoacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe dhe marrëveshjen për revitalizimin e urës në Mitrovicë

Marrëveshjet e dialogut teknik ^{1 2}

PJESËRISHT E ZBATUAR	PJESËRISHT E ZBATUAR	PJESËRISHT E ZBATUAR	E ZBATUAR	E PAZBATUAR
MARRËVESHJA PËR KADASTRËN	2 KORRIK 2011 MARRËVESHJA PËR REGJISTRAT CIVIL	2 KORRIK 2011 MARRËVESHJA PËR LIRINË E LËVIZJES	2 SHTATOR 2011 MARRËVESHJA PËR VULAT DOGANORE	2 KORRIK 2011 / 21 NËNTOR 2011 MARRËVESHJA PËR PRANIMIN E DIPLOMAVE UNIVERSITARE 2 KORRIK
NË PROCES TË ZBATIMIT	PJESËRISHT E ZBATUAR	E ZBATUAR	E PAZBATUAR	E PAZBATUAR
2 DHJETOR 2011 MARRËVESHJA PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË KUFIRIT	24 SHKURT 2012 MARRËVESHJA PËR PËRFAQËSIM DHE BASHKËPUNIM RAJONAL	17 JANAR 2013 MARRËVESHJA E BRUKSELIT PËR MBLEDHJEN E TË HYRAVE DOGANORE	30 MAJ 2013 MARRËVESHJA PËR ZYRTARËT NDËRLIDHËS	8 SHTATOR 2013 MARRËVESHJA PËR ENERGIJËN
NË PROCES TË ZBATIMIT	NË PROCES TË ZBATIMIT	PJESËRISHT E ZBATUAR	E ZBATUAR	NË PROCES TË ZBATIMIT
8 SHTATOR 2013 MARRËVESHJA PËR TELEKOMIN	4 SHTATOR 2014 MARRËVESHJA E BRUKSELIT PËR DIZAJNIMIN E PIKËKALIMEVE TË PËRHERSHME TË IBM NË MES TË DY SHTETEVE	26 MARS 2015 MARRËVESHJA PËR SHPËRBERJEN E TË ASHTUQUAJTURËS 'MBROJTJA CIVILE'	25 QERSHOR 2015 MARRËVESHJA RECIPROKE PËR NJOHJEN E POLICAVE(SIGURIMEVE) TË AUTOMJETEVE	27 QERSHOR 2015 MARRËVESHJA PËR CERTIFIKATAT E PRODUKTEVE FARMACEUTIKE (CPF)
	E PAZBATUAR	E ZBATUAR		
	25 GUSHT 2015 MARRËVESHJA PER DIZAJNIN E RIVITALIZIMIT TË URËS SË MITROVICËS	19 PRILL 2016 MARRËVESHJA E BRUKSELIT PËR NJOHJEN RECIPROKE TË CERTIFIKATAVE ADR		

1. Sqarim: informacioni lidhur me zbatimin e marrëveshjeve është i bazuar në raportet zyrtare të Qeverisë së Kosovës

2. Si pasojë e mungesës së transparencës nuk mund të saktësohet me precizitet zbatimi i plotë ose i pjesërishtëm i shumë marrëveshjeve. Kjo sepse palët negociuese në vazhdimësi kanë shpalosur interpretime të ndryshme, tek sa edhe BE shpesh here nuk ka intervenuar për të mbështetur apo hedhur poshtë pohimet e përfaqësuesve të Kosovës dhe Serbisë.

Marrëveshjet e dialogut politik ^{3 4}

NË PROCES TË ZBATIMIT	NË PROCES TË ZBATIMIT	E PAZBATUAR
19 PRILL 2013 MARRËVESHJA E PARË E PARIMEVE QË RREGULLOJNË NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE	9 SHKURT 2015 MARRËVESHJA PËR DREJTËSI	25 GUSHT 2015 MARRËVESHJA PËR ASOCIACIONIN/BASHKËSINË E KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE NË KOSOVË-PARIMET E PËRGJITHSHME/ELEMENTET KRYESORE

3. E zbatuar – zbatim i plotë; Pjesërisht e zbatuar – është zbatuar vetëm një pjesë e marrëveshjes; Në proces të zbatimit – marrëveshja është duke u zbatuar; E pazbatuar – nuk ka filluar fare të zbatohet

4. Mun

MUNGESA E TRANSPARENCËS

Që nga fillimi, dialogu Kosovë-Serbi është karakterizuar nga mungesa e llogaridhënies dhe transparencës. Për shumë kënd, dialogu ka qenë më shumë një dialog i elitave sesa një proces që i adreson nevojat e qytetarëve.⁵⁶ Nga ana e BE-së, mostransparenca lidhur me këtë proces është argumentuar të jetë si pasojë e brishtësisë dhe kompleksitetit që ka ky proces.⁵⁷ Meqë temat që janë diskutuar gjatë këtij procesi kanë prekur çështje mjaft delikate të marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, Bashkimi Evropian e ka konsideruar të udhës që procesi të jetë thujtë krejtësisht i mbyllur.⁵⁸ Megjithatë, transparenca dhe hapja e procesit ndaj publikut është konsideruar si domosdoshmëri në mënyrë që të shmangen mospajtimet e mëpastajme në fazën e zbatimit të marrëveshjeve.⁵⁹ Kjo qasje e mbyllur e dialogut, e marrëveshjeve të arritura dhe rezultateve të tyre, ka prodhuar paqartësi, pakënaqësi si dhe polarizim të skenës politike.

Zyra e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë dhe Zv. Presidente e Komisionit Evropian lëshoi komunikata të rregullta mbi takimet formale të mbajtura dhe temat e diskutimit por ato nuk ofruan transparencë mbi procesin pasi ato në përgjithësi ishin shumë të përgjithshme pa ofruar detaje relevante mbi të arriturat e takimeve.

Ueb faqja e zyrës së Kryeministrit shërbeu si një dritare informacioni ku një pjesë e marrëveshjeve u publikuan, por publikimi i tyre në shumë raste u bë me vonë dhe për

një pjesë të tyre siç është marrëveshja e drejtësisë, plani i zbatimit të së cilës ende mbahet i fshehur.⁶⁰ Përmbajtja e kësaj marrëveshjeje në versionin në gjuhën serbe marrëveshja ka 15 pika ndërsa në atë shqip 14 pika.⁶¹

Ministria për Dialog dhe ish kryenegociatorja znj. Edita Tahiri në emër të Qeverisë së Kosovës i ka dorëzuar Bashkimit Evropian/Shërbimit Evropian për veprime të jashtme raporte periodike rreth gjendjes së implementimit të marrëveshjeve të dialogut⁶², megjithatë ato janë publikuar në ueb faqen zyrtare të zyrës së kryeministrit, raportime të rregullta në Kuvendin e Kosovës të kësaj natyre nuk kanë ndodhur, përveç në rastet e pyetjeve parlamentare, të thirrjeve për raportime në Komisionet parlamentare apo interpelanca, të cilat kanë qenë të rralla. Raportet e qeverisë për gjendjen e dialogut nuk janë të përkthyer në gjuhën serbe duke i pamundësuar kështu komunitetit serb në Kosovë qasje në këto dokumente.⁶³

Në dokumentin e ashtuquajtur Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Dialogun e Brukselit /periudha 2014 – 2018/ të ish Ministres për Dialog znj. Edita Tahiri, ajo e ka justifikuar mungesën e transparencës së plotë për shkak të konfidencialitetit si rezultat i ndjeshmërisë së këtij procesi. Megjithatë ajo vetë ka deklaruar se në fazën vijuese të dialogut transparenca duhet të rritet dhe se kjo mund të arrihet edhe me hapjen e një ueb faqeje për dialogun, botimin e publikimeve për të dy fazat e dialogut atij teknik dhe për normalizim, botimin e broshurave udhëzuese për

⁵⁶ Shih Bieber, F. (2015). "The Serbia-Kosovo Agreements: An EU Success Story?" Review of Central and East European Law 40 (2015) 285-319, dhe Beha, A. (2015). Disputes over the 15-points agreement on normalization of relations between Kosovo and Serbia. Nationalist papers 43(1), fq. 102-12.

⁵⁷ Bieber, F.(2015), vepër e cituar

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ Grupi për Studime Politike dhe Juridike (GLPS), Aubrey Hamilton, "From Technical Arrangements to Political Haggling", shkurt 2012. E qasshme në, <http://legalpoliticalstudies.org/download/Policy%20Report%2002%202012%20english.pdf>. Shih gjithashtu, International Crisis Group, "Serbia and Kosovo: The Path to Normalisation", Europe Report, 19 shkurt 2013, Nr.223.. E qasshme në, <https://www.crisisgroup.org/europe-central-asia/balkans/serbia-and-kosovo-path-normalisation>

⁶⁰ Edhe KDI ka bërë kërkesë për qasje në dokumente publike rreth kësaj marrëveshjeje ndaj Zyres së Presidentit, Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial megjithatë asnjëra nga ato nuk ka ofruar informacionet e kërkuara.

⁶¹ Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Marrëveshja e Drejtësisë. E qasshme në, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Marreveshja_per_Drejttesi_-_09022015.pdf. Qeveria e Serbisë, Marrëveshja e Drejtësisë në gjuhën serbe. E qasshme në, <http://www.kim.gov.rs/eng/p06.php>

⁶² Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Raportet e ish ministres për dialog. Të qasshme në, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,252>

⁶³ Po aty, uebfaqja në gjuhën serbe. E qasshme në, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=3,252>

qytetarët për të shfrytëzuar më mirë shërbimet që i ofrojnë marrëveshjet, etj.⁶⁴ Megjithatë tri vite pas publikimit të këtij dokumenti, asnjë nga këto veprime nuk janë realizuar nga qeveria.

Përveç deputetëve të Kuvendit as publiku nuk është informuar si duhet rreth dialogut dhe marrëveshjeve të dala nga ky proces. Në një hulumtim të opinionit publik të organizuar nga KDI, pjesa dërrmuese e qytetarëve, mbi 75%, janë të pakënaqur me nivelin e përfshirjes së tyre në dialog, qoftë përmes diskutimeve apo edhe konsultimeve publike ndërsa 43% e qytetarëve të Republikës së Kosovës janë shprehur se nuk janë në dijeni për asnjë marrëveshje.⁶⁵

Poashtu, pjesa më e madhe e qytetarëve të Kosovës besojnë se krijimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe është i dëmshëm.⁶⁶ Është e rëndësishme të theksohet se krijimi i asociacionit konsiderohet i dobishëm vetëm nga komuniteti serb.⁶⁷ Ndërsa, në rastin e marrëveshjeve për integrimin e strukturave paralele, pjesa më e madhe e qytetarëve nuk besojnë se integrimi do të jetë i suksesshëm.⁶⁸ Qytetarët janë gjithashtu skeptik lidhur me normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.⁶⁹ Më shumë se gjysma e qytetarëve nuk shohin ndonjë përmirësim në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve dhe nuk besojnë se dialogu i Brukselit ka arritur t'i normalizojë marrëdhëniet Kosovë-Serbi.⁷⁰

BE nuk ka artikulluar asnjë herë se çfarë nënkupton normalizimi i marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë duke theksuar në vazhdimësi qëndrimin neutral ndaj statusit të Kosovës që reflektohet edhe në dokumentet e nënshkruara në mes Kosovës dhe BE-së. Për më tepër, dialogu Kosovë-Serbi dhe marrëveshjet e arritura në kuadër

të këtij procesi nuk kanë ndikuar në ndryshimin e qëndrimit nga 5 shtetet jo njohëse të BE-së.⁷¹ Është shënuar një kundërshtim i thellë nga shteti i Spanjës deri në refuzim të pjesëmarrjes së Presidentit në takime ku kanë qenë prezent lideret kosovar.⁷²

Pala kosovare ka artikulluar qëndrime të ndryshme rreth normalizimit të marrëdhënieve duke variuar nga njohja e ndërsjellë, deri te anëtarësimi në organizata ndërkombëtare pa pengim nga ana e Serbisë pa nevojë të njohjes.⁷³ Ndërsa pala serbe ka deklaruar se palët duhet të arrijnë një kompromis për të zgjidhur çështjen e Kosovës duke hequr nga tavolina opsionin e njohjes së ndërsjellë.⁷⁴

Edhe kur dialogu po shkon drejt fazës së re dhe pritet të ndodh takimi i rradhës në mes dy Presidentëve me ndërmjetësim të BE-së, ekzekutivi nuk ka prezantuar ndonjë dokument se si pritet të zhvillohet kjo fazë dhe cila do të jetë qasja e shtetit të Kosovës në dialogun me Serbinë. Kuvendi i Kosovës dhe publiku i gjerë vazhdojnë të mbeten të painformuar rreth asaj se si do të vazhdojë ky proces.

64 Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ministria për Dialog, Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Dialogun e Brukselit /periudha 2014 – 2018/, 15 janar 2015. I qasshëm në, http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_i_Qeveris%C3%AB_s%C3%AB_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_per_Dialogun_e_Brukselit_-_periudha_2014-2018_-_150115.pdf

65 KDI, Hulumtimi i opinionit publik, "Transparenca e Dialogut Kosovë-Serbi: Këndvështrimi i Qytetarëve", shtator 2016. I qasshëm në, <http://votaim.org/Public/Article?PollDialog=true&PollDialog=false&SelectedTab=Polls&PollSelectedMonthID=&PollSelectedYear=#polls>

66 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), Barometri Kosovar i Sigurisë: "Edicion Special: Perceptimi Publik për Politikën e Jashtme të Kosovës dhe Dialogun me Serbinë", shkurt 2018. I qasshëm në, http://www.qkss.org/repository/docs/KSB-2017-Politika_e_Jashtme_182137.pdf

67 Po aty.

68 KDI, Hulumtim i opinionit publik "6 vite pas: (mos)Konsolidim i shtetësisë: Këndvështrimi i qytetarëve rreth dialogut Kosovë – Serbi", prill 2017. I qasshëm në, <http://www.votaim.org/Public/Article?PollDialog=true&PollDialog=false&SelectedTab=Polls&PollSelectedMonthID=&PollSelectedYear=#polls>

69 QKSS, Barometri Kosovar i Sigurisë: "Edicion Special: Perceptimi Publik për Politikën e Jashtme të Kosovës dhe Dialogun me Serbinë".

70 KDI, Hulumtim i opinionit publik, "Normalizimi i marrëdhënieve Kosovë – Serbi, këndvështrimi i qytetarëve", KDI, shkurt 2018. I qasshëm në, <http://www.votaim.org/Public/Article?PollDialog=true&PollDialog=false&SelectedTab=Polls&PollSelectedMonthID=&PollSelectedYear=#polls>

71 ISPI, Francesco Martino, "Kosovo: Beyond the "Brussels Agreement", Analysis No. 254, Maj 2014. I qasshëm në, http://www.ispionline.it/sites/default/files/publicazioni/analysis_254_2014.pdf

72 Koha Net, "Propozohet heqja e flamurit të Kosovës në samitin e Sofjes për të bindur Spanjën të marrë pjesë", 17 mars, 2018. I qasshëm në, <http://www.koha.net/arberi/81586/propozohet-heqja-e-flamurit-te-kosoves-ne-samitin-e-sofjes-per-te-bindur-spanjen-te-marre-pjese/>

73 VOA, "Intervistë me Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi" 7 shkurt, 2018. I qasshëm në <https://www.zerimerikes.com/a/4243121.html>. Koha Net, "Pacolli përkujton takimin me Millosheviqin, Vuçiqin...", 4 dhjetor, 2017. I qasshëm në, <http://www.koha.net/arberi/61346/pacolli-perkujton-takimin-me-millosheviqin-vuciqin/>

74 Koha Net, "Vuçiq: Nëse dialogu zhvillohet vetëm për ta njohur Kosovën, atëherë mirupafshim", 25 janar 2018. I qasshëm në, <http://www.koha.net/arberi/71523/vuciq-nese-dialogu-zhvillohet-vetem-per-ta-njohur-kosoven-atehere-mirupafshim/>

LLOGARIDHËNIA

I gjithë procesi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është karakterizuar me mungesë llogaridhënie nga përfaqësuesit e Republikës së Kosovës. Si një dialog i elitave, nuk është konsideruar si një proces i mirëfilltë llogaridhënës i cili zhvillohet nga poshtë-lartë dhe garanton gjithpërfshirje dhe transparencë.⁷⁵ Në këtë kontekst, kanë munguar takime konsultative me shoqërinë civile dhe me qytetarët në mënyrë që këta të mbahen të informuar për përmbajtjen e dialogut apo edhe të dëgjohen dhe përfshihen kërkesat dhe shqetësimet e tyre në këtë proces.

Llogaridhënia ka munguar edhe në raport me institucionin më të lartë përfaqësues në vend, Kuvendin e Republikës së Kosovës. Gjatë legjislaturës së katërt, Kryeministri Hashim Thaçi është akuzuar vazhdimisht nga opozita për mungesë të raportimeve lidhur me procesin e dialogut.⁷⁶ Edhe qeveria pasuese, në periudhën e legjislaturës së pestë, është karakterizuar me mungesë llogaridhënie për çështjen e dialogut. Gjatë kohës sa ishte në krye të qeverisë, Kryeministri Isa Mustafa kishte raportuar vetëm një herë në Kuvendin e Kosovës për dialogun e Brukselit, pas arritjes së marrëveshjes për drejtësinë më 9 shkurt 2015. Në shtator të vitit 2015, edhe pse ishte ftuar për të raportuar për marrëveshjen e 25 gushtit, për themelimin e Asociacionit/bashkësisë së komunave serbe, Kryeministri Mustafa u pengua ta bënte një gjë të tillë nga opozita e atëhershme në Kuvendin e Kosovës, duke hedhur gjësende në drejtim të foltores së kryeministrit.⁷⁷ Pas kësaj seance, kryeministri Mustafa nuk kishte raportuar më për çështjen e dialogut deri në fund të mandatit të tij.

Vlen të theksohet se edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk kanë qenë aktiv në ushtrimin e së drejtës së tyre për të parashtruar pyetje parlamentare lidhur me procesin e dialogut Kosovë-Serbi. Nga gjithsej 428 pyetje parlamentare që ishin parashtruar gjatë legjislaturës së pestë, vetëm 28 (rreth 7 %) prej tyre kanë qenë të ndërlidhura me procesin e dialogut Kosovë – Serbi. Ndërsa, nga 28 pyetjet e parashtruara nga deputetët e Kuvendit të Kosovës lidhur me çështjen e dialogut, vetëm gjysma e tyre kanë marrë përgjigje nga ekzekutivi. Edhe në pyetjet e parashtruara nga deputetët e Kuvendit të Kosovës për kryeministrin Isa Mustafa (gjithsej 11), kryeministri ishte përgjigjur në vetëm tri prej tyre. Ndërsa në legjislaturën aktuale, Kuvendi i Kosovës nuk ka mbajtur asnjë debat parlamentar mbi çështjet që ndërlidhen me dialogun. Kryeministri Haradinaj nuk ka raportuar ende në Kuvend mbi këtë çështje, ndërsa udhëheqësi i ekipit të ri negociues z. Avni Arifi ka raportuar në Komisionin Për Punç të Jashtme⁷⁸ por jo dhe në seancë plenare.

⁷⁵ Shih Bieber, F. (2015). "The Serbia-Kosovo Agreements: An EU Success Story?" Review of Central and East European law 40 (2015) 285-319, dhe Beha, A. (2015). Disputes over the 15-points agreement on normalization of relations between Kosovo and Serbia. Nationalist papers 43(1), 102-12

⁷⁶ Portali Telegrafi, "Opozita akuzon Thaçin se nuk po raporton për bisedimet", 22 mars, 2014. I qasshëm në, <https://telegrafi.com/opozita-akuzon-thacin-nuk-po-raporton-per-bisedimet/>

⁷⁷ Koha Net, "Kryeministri gjuhet me vezë, ndërpritet seanca e Kuvendit ëvideoc", 22 shtator 2015. I qasshëm në, <http://archive.koha.net/?id=27&l=76068>

⁷⁸ Avni Arifi raporton në Komision për punë të jashtme, <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,110,140>

RRUGËTIMI DREJTË BE-së

Dialogu Kosovë-Serbi është një nga proceset kyçe për avancimin e Kosovës dhe Serbisë në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian. Në raportimet vjetore të Komisionit Europian mbi progresin e Kosovës në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE, normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë i është kushtuar rëndësi e veçantë. Pothuajse në të gjitha raportet e progresit, që prej fillimit të dialogut politik, theksohet qartë se progresi në drejtim të normalizimit të marrëdhënieve mbetet thelbësorë për avancim në rrugën e tyre evropiane si për Serbinë ashtu edhe për Kosovën.⁷⁹ Përmirësimi i marrëdhënieve me Kosovën si parakusht për integrim në BE përmendet edhe në kapitullin e 35-të të anëtarësimit për Serbinë.⁸⁰ Në këtë kapitull, BE kërkon nga Serbia përkushtim dhe rezultate në procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën, duke theksuar se procesi i anëtarësimit dhe normalizimit duhet të zhvillohen në mënyrë paralele dhe përkrahin njëra-tjetrën.⁸¹

Kësisoj, në këmbim të angazhimit dhe përkushtimit të të dyja vendeve në dialogun për normalizim të marrëdhënieve, BE ka ofruar përfitime të prekshme për të dyja vendet në rrugën e tyre drejt Bashkimit Europian. Pas arritjes së marrëveshjes së parë të parimeve për normalizim të marrëdhënieve, në prill të viti 2013, Këshilli Europian vendosi që të hap negociatat për anëtarësim me Serbinë në njërin anë, si dhe të hap negociatat për marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me Republikën e Kosovës në anën tjetër, si shpërblim për progresin e bërë në rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve.⁸² Përderisa Republika e Serbisë i ka mbyllur dy kapituj të negociatave për

anëtarësim nga 12 sa i ka të hapur për negociatim, Republika e Kosovës dhe Bashkimi Europian nënshkruan marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me 2 tetor 2015, e cila hyri në fuqi me 1 prill 2016.⁸³ Nënshkrimi i kësaj marrëveshje ishte mundësuar falë traktatit të Lisbonës i cili i jep legalitet juridik Komisionit Europian për nënshkrimin e marrëveshjeve në emër të Unionit pa pasur nevojë që një marrëveshje e tillë të ratifikohet nga të gjithë anëtarët e Unionit.

Megjithë dallimet të cilat Marrëveshja e Stabilizim Asociimit për Kosovën ka me MSA-të e vendeve të rajonit, nënshkrimi i MSA-së është konsideruar si një arritje e jashtëzakonshme për Republikën e Kosovës meqë shënon marrëveshjen e parë kontraktuale me Bashkimin Europian.⁸⁴ Për më shumë, përveç mundësisë që MSA i ofron Kosovës për të pasur qasje në tregun e përbashkët Europian, zbatimi i saj do të sjellë rezultate të rëndësishme për Kosovën, duke e avancuar demokracinë, ndër të tjera, gjë që do të kishte efekte pozitive për vendin. Zbatimi i MSA do t'i sjellë Kosovës përfitime në fushën ekonomike, sundimit të ligjit, edukimit, industrisë, ambientit, energjisë dhe shumë të tjera. Poashtu, përveç përfitimeve në fushat e lartëcekura që ndihmojnë në përafrimin e legjislacionit vendas me atë të BE-së, MSA-ja është një instrument shumë i rëndësishëm në luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, shpërlarjes së parave dhe terrorizmit.⁸⁵ Në të njëjtën kohë, nënshkrimi i MSA është një sinjal i qartë politik për Kosovën se angazhimi në plotësimin e kriterëve të BE-së sjellë rezultate pavarësisht pengesave politike.

Sidoqoftë, Kosova ende mbetet vendi i vetëm i Ballkanit

⁷⁹ Komisioni Evropian, Raportet e Progresit për Kosovën. Të qasshme në, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/package_en

⁸⁰ Qëndrimi i përbashkët i Bashkimit Europian, Kapitulli 35, 30 nëntor 2015. I qasshëm në, <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/AD-12-2015-INIT/en/pdf>

⁸¹ Po aty, fq 2.

⁸² Këshilli i Bashkimit Europian, 21 janar, 2014. I qasshëm në: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/genaff/140676.pdf dhe Komisioni Europian, 22 prill 2013. I qasshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2013/ks_spring_report_2013_en.pdf

⁸³ Marrëveshja e stabilizim asociimit ndërmjet Bashkimit Europian dhe Kosovës, 2 tetor 2015. I qasshëm në, https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/stabilisation_and_association_agreement_eng_0.pdf

⁸⁴ Kosovo Foundation for Open Society (KFOS). Augustin Palokaj dhe Gjeraqina Tuhina "The Upshot of the SAA: Kosovo-EU relations", 2016. I qasshëm në, http://kfos.org/wp-content/uploads/2016/11/MSA-ENG_TEXT-2.compressed.pdf

⁸⁵ Po aty.




Kosova ende mbetet vendi i vetëm i Ballkanit perëndimor pa një të ardhme të qartë të anëtarësimit në Bashkimin European. ▮▮



perëndimor pa një të ardhme të qartë të anëtarësimit në Bashkimin European kjo për shkak të pesë vende anëtare të cilat nuk njohin shtetin e Kosovës. Në strategjinë e zgjerimit të publikuar në fillim të muajit shkurt 2018, Kosovës i premtohet avancim në rrugën e saj drejt Bashkimit European nëse rrethanat objektive lejojnë.⁸⁶ Duke nënvizuar se normalizimi i plotë i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është domosdoshmëri për të dy vendet në mënyrë që të avancojnë në rrugën e tyre europiane, në këtë strategji BE kërkon që dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të përmbillet me një marrëveshje ligjërisht të obligueshme, e cila do t'i zgjidhte problemet e hapura ndërmjet dy vendeve, përfshirë demarkimin e kufirit si dhe mospengimin e njëra-tjetrës në arenën ndërkombëtare.⁸⁷ Megjithatë, pavarësisht faktit se në këtë strategji BE nënvizon se nga përmbyllja e dialogut me Serbinë, Kosova do të përfitojë në rrugën e saj Europiane, në asnjë moment nuk specifikohet se si dhe çfarë do të jetë ky përfitim.

Është e rëndësishme të theksohet se edhe pse normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mbetet një parakusht themelorë për të dyja vendet për të avancuar në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE, edhe në këtë strategji theksohen qartë sfidat e të dy vendeve, me theks të vecantë problemet e mëdha me sundimin e ligjit, kapja e shtetit, korrupsioni dhe krimi i organizuar.



⁸⁶ Komisioni European, "A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans", 2018. I qasshëm në, https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf

⁸⁷ Po aty.



DIALOG I BRENDSHËM NË SERBI

Zgjidhja e problemit me Kosovën mbetet parakushti kryesor për Serbinë në rrugën e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian.⁸⁸ Bashkimi Europian, e në veçanti disa nga anëtarët kryesor individualisht, e kanë theksuar në vazhdimësi se rruga e anëtarësimit në BE për Serbinë 'kalon kah Kosova'.⁸⁹ Në këtë kontekst, me të marr postin e Presidentit, Aleksandër Vuçiç ka inicuar një dialog të brendshëm me qëllim të arritjes së një konsensusi të gjerë në Serbi lidhur me të ardhmen e marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Përveç arritjes së konsensusit lidhur me të ardhmen e marrëdhënieve me Kosovën, Vuçiç ka kërkuar gjithashtu të ndërmerren hapa konkret në këtë drejtim, përfshirë ndryshime kushtetuese, në mënyrë që Serbia të avancojë në rrugën e saj Europiane.⁹⁰ Në një shkrim autorial, Vuçiç ka thënë se "ka ardhur koha që si popull të mos sillemi më si struci dhe të fusim kokën në rërë. Duhet të përpiqemi të bëhemi realistë, të mos i lejojmë vetes të humbim ose t'ia dorëzojmë dikujt atë që kemi. Por nuk duhet të presim që në dorë të na kthehet ajo që e kemi humbur kaherë".⁹¹

Në këtë dialog janë përfshirë të gjitha institucionet dhe subjektet e rëndësishme të Serbisë, përfshirë akademinë, kishën ortodokse serbe, shoqërinë civile, mediet dhe grupe e individë të tjerë të interesuar në këtë çështje. Për rreth gjashtë muaj, janë organizuar disa raunde diskutimesh ndërmjet këtyre akterëve me qëllim që të diskutohen idetë, propozimet, vizionet dhe modalitetet për zgjidhjen e problemit me Kosovë.⁹² Partitë

radiakale dhe Kisha Ortodokse Serbe në vazhdimësi janë shfaqur kundër çfarëdo kompromisi me Kosovën, përderisa zëra që kundërshtojnë normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën kanë ardhur edhe nga anëtarë të Qeverisë së Serbisë, përfshirë ministrin e Jashtëm, Ivica Dacic, dhe atë të brendshëm, Aleksandër Vulin.⁹³

Në këtë mënyrë, dialogu i brendshëm në Serbi, deri më tani, ka shpërfaqur polarizimet e skajshme ndërmjet aktorëve relevantë si dhe shoqërisë në përgjithësi. Megjithatë, ky dialog, i cili pritet të përfundojë së shpejti, ka për qëllim të nxjerrë një qëndrim të përbashkët të institucioneve dhe shoqërisë serbe lidhur me të ardhmen e marrëdhënieve me Kosovën, mbi bazën e së cilit, do të ndërtohet një platformë dhe ofrohet një zgjidhje nga ana e Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve.⁹⁴

Presidenti Vuçiç ka deklaruar se do të paraqes propozimin për zgjidhjen e çështjes së Kosovës në fund të marsit apo në fillim të prillit. Ashtu siç kishte paralajmëruar, ai ka filluar takimet në enklavat serbe në Kosovë për të integruar dhe qëndrimin e tyre në këtë diskutim. Takime të tilla janë mbajtur më 7 dhe 8 mars 2018.⁹⁵ Deri më tani, në publik kanë dalë disa propozime si epilog i mundshëm i dialogut, duke filluar nga ndarja e Kosovës, shkëmbimi i territoreve, e deri te autonomia e serbëve brenda Kosovës.⁹⁶

⁸⁸ Po aty.

⁸⁹ Portali Express, "Mesazh i qartë i Gjermanisë pas zgjedhjeve: Serbia duhet ta njoh Kosovën", 17 mars 2014, I qasshëm në, <http://www.gazetaexpress.com/lajme/mesazh-i-qarte-i-gjermanise-pas-zgjedhjeve-serbia-duhet-ta-njoh-kosoven-3556/?archive=1>. Portali Lajmi.net, "Ministri gjerman: Serbia para se të hyjë në BE duhet ta njoh Kosovën". I qasshëm në, <http://lajmi.net/ministri-gjerman-serbia-para-se-te-hyje-ne-be-duhet-ta-njoh-kosoven/>, dhe Gazeta Blic, "Ministri i Gjermanisë: S'ka BE për Serbinë pa e njohur Kosovën", shkurt 2018. I qasshëm në, <https://gazetablic.com/ministri-gjermanise-ska-per-serbine-pa-e-njohur-kosoven/>

⁹⁰ Portali Express, "Serbia mund ta heq Kosovën nga Kushtetuta në fund të 2017-s", 8 maj 2015. I qasshëm në, <http://www.gazetaexpress.com/lajme/serbia-mund-ta-heq-kosoven-nga-kushtetuta-ne-fund-te-2017-s-99624/?archive=1>

⁹¹ Koha Net, "Vuçiç për Kosovën: Të jemi realë, mos të fshëhim kokën si struci", 24 korrik 2017. I qasshëm në, <http://www.koha.net/arberi/33635/vucic-per-kosoven-te-jemi-reale-mos-te-fshehim-koken-si-struci/>

⁹² Gazeta Observer, "Dialogu i brendshëm për Kosovën në Serbi, sot flasin sportistë, priftërinj, shkencëtarë", 12 dhjetor, 2017. I qasshëm në, <http://gazetaobserver.com/dialogu-brendshem-per-kosoven-ne-serbi-sot-flasin-sportiste-prifterinj-shkencetare/>

⁹³ Koha.net, "Vulin: Serbia nuk do ta njohë Kosovën që të bëhet anëtare e BE-së", 15 shkurt 2018. I qasshëm në, <http://www.koha.net/arberi/75761/vulin-serbia-nuk-do-ta-njoh-kosoven-qe-behet-anetare-e-be-se/>

⁹⁴ Koha.net, "Dialogu i brendshëm për Kosovën po del të jetë puna më e vështirë për Serbinë", 30 tetor 2017. I qasshëm në, <http://www.koha.net/arberi/54211/dialogu-i-brendshem-per-kosoven-po-del-te-jete-puna-me-e-veshtire-per-serbine/>

⁹⁵ Koha Net, "Dialogu i brendshëm i Serbisë edhe në Kosovë, Qeveria hesht", 8 mars 2018. I qasshëm në, <http://www.koha.net/arberi/79711/dialogu-i-brendshem-i-serbise-edhe-ne-kosove-qeveria-hesht/>

⁹⁶ Zëri Info, "Ideja e ministrit serb për ndarjen e Kosovës bën bujë në mediat ndërkombëtare", 6 shkurt 2018. I qasshëm në, <http://zeri.info/aktuale/185345/ideja-e-ministrit-serb-per-ndarjen-e-kosoves-ben-buje-ne-mediat-nderkombetare/>. Koha Net, "Karrige në OKB për Kosovë,



PLATFORMA SHTETËRORE PËR FAZËN E RE TË DIALOGUT KOSOVË-SERBI

Pala kosovare është duke e ndjekur trendin e njëjtë rreth fazës së re të dialogut, ku pavarësisht deklaratave e thirrjeve për konsensus politik është duke e vazhduar dialogun pa një konsultim të gjerë politik apo shoqëror.

Ajo çfarë është duke ndodhur është vazhdimi i bisedave pas perdeve dhe dakordësimeve të fshehura, qasje e cila mund vetëm të dëmtojë të ardhmen e Kosovës dhe të çënoj pritjet nga ky proces.

Siç u argumentua edhe në këtë dokument, procesi i dialogut deri më tani është karakterizuar nga mungesa e transparencës dhe llogaridhënies, marrëveshje të pazbatuara ku dhe vet përmbajtja e tyre është kontestuar, ndërsa pala kosovare nuk e ka artikuluar qartë se çfarë synon të arrijë me këtë proces.

Faza e re e dialogut duhet të zhvillohet mbi disa parime bazë të cilat mund të çojnë palën kosovare drejtë ndërtimit të një platforme shtetërore mbi bazën e një konsensusi të gjerë politik, arritjen e legjitimitit institucional dhe atë qytetar. Duhet të bëhet një vlerësim gjithpërfshirës i procesit të dialogut dhe marrëveshjeve të arritura. Të gjeturat e këtij vlerësimi të reflektojnë në fazën e re të dialogut.

Patjetër që rezultatet e të cilit si proces i dialogut duhet të sjellin konsolidimin të brendshëm shtetëror dhe konsolidimin e subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës. KDI ka organizuar gjatw periudhës 2 vjeçare një sërë aktiviteteve me deputetë të Kuvendit të Kosovës, përfaqësues të Qeverisë, të organizatave jo qeveritare, të medias në mbarë vendin ku janë artikuluar një pjesë e rekomandimeve të cilat kanë sjell te propozimi i rekomandimeve të mëposhtme.

autonomi për serbët e saj, zgjidhja sipas Beogradit", 25 shkurt, 2018. I qasshëm në, <http://www.koha.net/arberi/77560/karrige-ne-okb-per-kosove-au-tonomi-per-serbet-e-saj-zgjidhja-sipas-beogradit/>. Zëri Info, "Drecun: Thaçi po na ofron shkëmbim terriroresh", 7 maj 2017. I qasshëm në, <http://zeri.info/aktuale/142163/drecun-thaci-po-na-ofron-shkembim-terriroresh/>



PARIMET BAZË PËR PLATFORMËN E DIALOGUT:

- **Ekipi negociues:** Ndërtimi i një ekipi gjithëpërfshirës politik i cili udhëheq bisedimet e dialogut Kosovë-Serbi i mbështetur nga një ekip ekspertësh në bazë të temave/fushave të cilat do të adresohen në kuadër të këtij procesi.
- **Konsensus politik:** Procesi i dialogut kërkon vigjilencë dhe përfshirje të gjerë politike. Andaj duhet të inicohen diskutime të liderëve politik lidhur me formatin, temat e dialogut si dhe epilogun i këtij procesi, me qëllim arritjen e një konsensusi të gjerë politik.
- **Transparenca:** Dialogu duhet të ofroj transparencë për qytetarët duke artikuluar marrëveshjet e arritura dhe efektet që këto marrëveshje do të kenë në jetën e tyre. Takimet informuese dhe konsultative me qytetarë dhe shoqërinë civile duhet të jenë të vazhdueshme përgjatë gjithë procesit.
- **Roli i Kuvendit:** Kuvendi duhet të ketë rolin e tij të pakontestuar e aktiv, duke i dhënë legjitimitet dhe legalitet bisedimeve të Brukselit. Kuvendi duhet të ushtroj rolin e tij mbikqyrës mbi të gjithë procesin negociator përfshirë këtu raportime të rregullta nga ekipi negociator para dhe pas arritjes së marrëveshjeve dhe konsultimin e komisioneve përkatëse.
- **Temat:** Temat të cilat duhet të diskutohen në kuadër të fazës së re të dialogut dhe të përfshihen në që ndërlidhen me ballafaqimin me të kaluarën, suksesionin dhe shpërbërjen e strukturave paralele në Kosovë.
- **Reciprocitetit:** Pala kosovare duhet të aplikoj parimin e reciprocitetit përgjatë gjithë procesit të dialogut.
- **Vijat e kuqe:** Marrëveshjet e arritura në kuadër të këtij procesi nuk duhet të çenojnë rregullimin shtetëror të shtetit unitar të Kosovës, nuk duhet të çenojnë integritetin e saj territorial dhe përfaqësimin e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran në arenën ndërkombëtare. Plani i Ahtisaarit është kompromisi i vetëm dhe i panegociushëm në dialog.
- **Epilogu:** Njohja e Kosovës nga i shteti i Serbisë, anëtarësimi i Kosovës si shtet me të drejta të barabarta në OKB.
- **Anëtarësim në OKB:** BE duhet të jetë sponsorizuese e një Rezolutive të re në kuadër të OKB-së e mbështetur nga SHBA-të. Kjo Rezolutive e re në OKB e cila i hap derën Kosovës për anëtarësim si shtet më të drejta të plota duke zhvlerësuar Rezolutën e OKB-së Nr. 1244.
- **Zbatimi i marrëveshjeve:** Etapa e re e dialogut, duhet të evitohet gabimet e së shkuarës duke përcaktuar qartë afatet kohore, mekanizmat zbatuese të marrëveshjeve, dhe masat ndëshkuese nga BE për palët që nuk i zbatojnë ato, duke e ndërlidhur këtë proces me avansimin e palëve drejtë BE-së.
- **Lobimi:** Shteti i Kosovës duhet krijoi një mekanizëm shtetëror të lobimit për mbështetjen e platformës së saj shtetërore të dialogut me kryeqendrat evropiane dhe SHBA-të. Ky lobim duhet të vazhdojë dhe më tej për arritjen e njohjeve të reja, në veçanti me 5 shtetet jo njohëse të BE-së si dhe anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

REFERENCAT

Bashkimi Evropian, "Deklarata e Përfaqësueses së Lartë Catherine Ashton mbi vazhdimin e dialogut të lehtësuar nga BE", 19 tetor 2012. I qasshëm në, http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_Data/docs/pressdata/EN/foraff/133036.pdf

Bashkimi Evropian, "Vërejtjet nga Përfaqësuesja e Lartë Catherine Ashton mbi dialogun e lehtësuar nga BE", 19 prill 2013. I qasshëm në, http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/foraff/136875.pdf

Bashkimi Evropian, "Deklaratë nga Përfaqësuesja e Lartë / Zvendës - Presidentja Federica Mogherini pas takimit të dialogut të lehtësuar nga BE", 25 gusht 2015. I qasshëm në, https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/3182/statement-by-high-representativevice-president-federica-mogherini-follo%C3%ABing-the-meeting-of-the-eu-facilitated-dialogue_en

Bashkimi Evropian, "Deklarata e Federica Mogherinit pas takimit të nivelit të lartë në kuadrin e Dialogut të ndërmjetësuar nga BE ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës", 24 janar 2017. I qasshëm në, https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/19150/federica-mogherinis-statement-following-high-level-meeting-framework-eu-facilitated-dialogue_en

Bashkimi Evropian, "Federica Mogherini takohet me Presidentin Vuçiq të Serbisë dhe Thaçi të Kosovës", 3 korrik 2017. I qasshëm në, https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/29156/federica-mogherini-meets-president-vu%C4%8Di%C4%87-serbia-and-tha%C3%A7i-kosovo_en

Bashkimi Evropian, "Federica Mogherini takohet me Presidentin Thaçi të Kosovës dhe Vuçiçin e Serbisë", 31 gusht, 2017. I qasshëm në, https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/31526/federica-mogherini-meets-president-tha%C3%A7i-kosovo-and-vu%C4%8Di%C4%87-serbia_en

Bashkimi Evropian, "Deklarata e zëdhënësit pas takimit punues në kuadër të Dialogut të lehtësuar nga BE", 27 shkurt 2018. I qasshëm në, https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/40471/statement-spokesperson-folloëing-ëorking-level-meeting-ëithin-eu-facilitated-dialogue_en

Bieber, F. (2015). "The Serbia-Kosovo Agreements: An EU Success Story?" Review of Central and East European Iaë 40 (2015) 285-319, dhe Beha, A. (2015). Disputes over the 15-points agreement on normalization of relations between Kosovo and Serbia. Nationalist papers 43(1).

BIRN, Bodo Weber, DPC, "BIG DEAL: TRUKU I NGATHË: Pasiguria Kushtetuese, Jostabiliteti Politik dhe Sundimi i ligjit në Dialogun Kosovë-Serbi", 2016. I qasshëm në, <http://prishtinainsight.com/wp-content/uploads/2016/04/BIRN-Report-2016-SHQIP.pdf>

BROOKINGS, OP-ED: "When Ambiguity is Destructive", Khaled Elgindy, 22 janar, 2014. I qasshëm në, <https://www.brookings.edu/opinions/when-ambiguity-is-destructive/>

David L. Phillips, Director of the Program on Peace-building and Rights Institute for the Study of Human Rights Columbia University, "Implementation Review of the Kosovo-Serbia Dialogue", 5 shtator 2017. I qasshëm në, http://www.humanrightscolumbia.org/sites/default/files/2017_09_05_kosovo-serbia_report.pdf

Gazeta Blic, "Ministri i Gjermanisë: S'ka BE për Serbinë pa e njohur Kosovën", shkurt 2018. I qasshëm në, <https://gazetablic.com/ministri-gjermanise-ska-per-serbine-pa-e-njohur-kosoven/>

Gazeta Observer, "Dialogu i brendshëm për Kosovën në Serbi, sot flasin sportistë, priftërinj, shkencëtarë", 12 dhjetor, 2017. I qasshëm në, <http://gazetaobserver.com/dialogu-brendshem-per-kosoven-ne-serbi-sot-flasin-sportiste-prifiterinj-shkencetare/>

Grupi për Studime Politike dhe Juridike (GLPS), Aubrey Hamilton, "From Technical Arrangements to Political Hagglng", shkurt 2012. E qasshme në, <http://legalpoliticalstudies.org/doënlload/Policy%20Report%2002%202012%20english.pdf>

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim në rastin nr. K095/13, 9 shtator 2013, e qasshme në http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ko_95_13_shq.pdf

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, AKTGJYKIMI në Rastin nr. K0130/15, 23 dhjetor 2015. I qasshëm në, http://www.votaime.org/Uploads/Data/Documents/VLARES~1_GmystyF653.PDF

Hulumtim Parlamentar i përgatitur nga Kushtrim Istrefi, për Komisionin për Integritet të Kuvendit të Kosovës, "Roli i Kuvendit në Dialogun Kosovë-Serbi dhe Rrugëtimi drejt BE-së", tetor 2017.

International Crisis Group, "Serbia and Kosovo: The Path to Normalisation", Europe Report, 19 shkurt 2013, Nr.223.. E qasshme në, <https://www.crisisgroup.org/europe-central-asia/balkans/serbia/serbia-and-kosovo-path-normalisation>

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), "Marrëveshja nuk krijon një OJQ por qon në nivel të tretë qeverisës", 26 gusht, 2015. I qasshëm në, <http://kdi-kosova.org/aktivitetet/marreveshja-nuk-krijon-nje-ojq-por-qon-ne-nivel-te-trete-qeverises/>

ISPI, Francesco Martino, "Kosovo: Beyond the "Brussels Agreement". Analysis No. 254, maj 2014. I qasshëm në, http://www.ispionline.it/sites/default/files/publicazioni/analysis_254_2014.pdf

Këshilli Evropian, "Deklaratë nga Presidenti i Këshillit Evropian Herman Van Rompuy, me rastin e marrëveshjes në kuadër të dialogut të lehtësuar mbi normalizimin e marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës", 19 prill, 2013. I qasshëm në, http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/ec/136877.pdf

Këshilli i Bashkimit Europian, 21 janar, 2014. I qasshëm në: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/genaff/140676.pdf dhe

Komisioni Europian, 22 prill 2013. I qasshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2013/ks_spring_report_2013_en.pdf

KDI, Hulumtimi i opinionit publik, "Transparenca e Dialogut Kosovë-Serbi: Këndvështrimi i Qytetarëve", shtator 2016. I qasshëm në, <http://votaime.org/Public/Article?PollDialog=true&PollDialog=false&SelectedTab=Polls&PollSelectedMonthID=&PollSelectedYear=#polls>

KDI, Hulumtim i opinionit publik "6 vite pas: (mos)Kkonsolidim i shtetësisë: Këndvështrimi i qytetarëve rreth dialogut Kosovë – Serbi", prill 2017. I qasshëm në, <http://www.votaime.org/Public/Article?PollDialog=true&PollDialog=false&SelectedTab=Polls&PollSelectedMonthID=&PollSelectedYear=#polls>

KDI, "Në tryezën e KDI-së, Presidenti Thaçi bën thirrje për konsensus nacional për të përmbyllur dialogun Kosovë-Serbi", 14 shtator 2017. I qasshëm në, <http://votaime.org/Public/DialogActivity/Detail/130>

KDI, Hulumtim i opinionit publik, "Normalizimi i marrëdhënieve Kosovë – Serbi, këndvështrimi i qytetarëve", KDI, shkurt 2018. I qasshëm në, <http://www.votaime.org/Public/Article?PollDialog=true&PollDialog=false&SelectedTab=Polls&PollSelectedMonthID=&PollSelectedYear=#polls>

Koha Net, "Kryeministri gjuhet me vezë, ndërpritet seanca e Kuvendit ëvideo", 22 shtator 2015. I qasshëm në, <http://archive.koha.net/?id=27&l=76068>

Koha Net, "Vuçiq për Kosovën: Të jemi realë, mos të fshehim kokën si struci", 24 korrik 2017. I qasshëm në, <http://www.koha.net/arberi/33635/vuciq-per-kosoven-te-jemi-reale-mos-te-fshehim-koken-si-struci/>

Koha net, "Dialogu i brendshëm për Kosovën po del të jetë puna më e vështirë për Serbinë", 30 tetor 2017. I qasshëm në, <http://www.koha.net/arberi/54211/dialogu-i-brendshem-per-kosoven-po-del-te-jete-puna-me-e-veshtire-per-serbine/>

Koha Net, "Pacolli përkujton takimin me Millosheviqin, Vuçiqin...", 4 dhjetor, 2017. I qasshëm në, <http://www.koha.net/arberi/61346/pacolli-perkujton-takimin-me-millosheviqin-vuciqin/>

Koha.net, "Vulin: Serbia nuk do ta njohë Kosovën që të bëhet anëtare e BE-së", 15 shkurt 2018. I qasshëm në, <http://www.koha.net/arberi/75761/vulin-serbia-nuk-do-ta-njohë-kosoven-qe-behet-anetare-e-be-se/>

Koha Net, "Vucic: Nëse dialogu zhvillohet vetëm për ta njohur Kosovën, atëherë mirupafshim", 25 janar 2018. I qasshëm në, <http://www.koha.net/arberi/71523/vuciq-nese-dialogu-zh-villohet-vetem-per-ta-njohur-kosoven-atehere-mirupafshim/>

Koha Net, "Karrige në OKB për Kosovë, autonomi për serbët e saj, zgjidhja sipas Beogradit", 25 shkurt, 2018. I qasshëm në, <http://www.koha.net/arberi/77560/karrige-ne-okb-per-kosove-autonomi-per-serbet-e-saj-zgjidhja-sipas-beogradit/>.

Koha Net, "Dialogu i brendshëm i Serbisë edhe në Kosovë, Qeveria hesht", 8 mars 2018. I qasshëm në, <http://www.koha.net/arberi/79711/dialogu-i-brendshem-i-serbise-edhe-ne-kosove-qeveria-hesht/>

Koha Net, "Propozohet heqja e flamurit të Kosovës në samitin e Sofjes për të bindur Spanjën të marrë pjesë", 17 mars, 2018. I qasshëm në, <http://www.koha.net/arberi/81586/propozohet-heqja-e-flamurit-te-kosoves-ne-samitin-e-sofjes-per-te-bindur-spanjen-te-marre-pjese/>

Komisioni European, "A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans", 2018. I qasshëm në, https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf

Komisioni Evropian, Raportet e Progresit për Kosovën. Të qasshme në, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/package_en

Kosovo Foundation for Open Society (KFOS). Augustin Palokaj dhe Gjeragina Tuhina "The Upshot of the SAA: Kosovo-EU relations", 2016. I qasshëm në, http://kfos.org/wp-content/uploads/2016/11/MSA-ENG_TEXT-2.compressed.pdf

Kuvendi i Republikës së Kosovës, "Rezolutë për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë", 10 mars, 2011. I qasshëm në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezoluta_per_dialogun_midis_R.Kosoves_dhe_R.Serbise_2.pdf

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Rezoluta "Për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë", 18 tetor 2012. I qasshëm në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezolute_Marredhenive_Kosova_Serbia.pdf

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Rezoluta "Për dhënie e pëlqimit për nënshkrim të Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë", 21 prill, 2013. I qasshëm në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezoluta_per_marreveshje.pdf

Kuvendi i Republikës së Kosovës, "Ligji Nr. 04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë", 27 qershor 2013. I qasshëm në, <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20ratifikimin%20e%20marreveshjes%20se%20pare%20per%20normalizimin%20e%20marredhenive%20Kosove%20Serbi.pdf>

Kuvendi i Republikës së Kosovës, "Rezolutë lidhur me ndalimin e ish-kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në Francë", 10 mars 2017. I qasshëm në, http://kuvendikosoves.org/common/docs/2017_03_09_Rezoluta_nr_011_per_lirimin_e_Ramush_Haradinaj.pdf

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Deklaratë, 30 mars 2017, fq.30. I qasshëm në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2017_03_30_10_6926_al.pdf

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Transkripti i seancës së Kuvendit, 17 dh-jetor 2017, fq.41. I qasshëm në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2017_12_14_10_7135_al.pdf

[Letër e drejtuar nga ish Ministria e Dialogut znj. Edita Tahiri, Ministri të Energjisë së Republikës së Shqipërisë z. Gjikhuri mbi moszbatimin e Marrëveshjes së Energjisë. I qasshëm në, \[http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Leter_nga_Ministrja_Tahiri_per_Ministrin_Gjikhuri_111016.pdf\]\(http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Leter_nga_Ministrja_Tahiri_per_Ministrin_Gjikhuri_111016.pdf\)](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Leter_nga_Ministrja_Tahiri_per_Ministrin_Gjikhuri_111016.pdf)

[Marrëveshja e stabilizim asociimit ndërmjet Bashkimit Europian dhe Kosovës, 2 tetor 2015. I qasshëm në, \[https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/stabilisation_and_association_agreement_eng_0.pdf\]\(https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/stabilisation_and_association_agreement_eng_0.pdf\)](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/stabilisation_and_association_agreement_eng_0.pdf)

[Organizata e Kombeve të Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, "Rezoluta A/RES/64/298", 9 shtator 2010. I qasshëm në, \[http://www.un.org/en/ga/search/vieë_doc.asp?symbol=A/RES/64/298\]\(http://www.un.org/en/ga/search/vieë_doc.asp?symbol=A/RES/64/298\)](http://www.un.org/en/ga/search/vieë_doc.asp?symbol=A/RES/64/298)

[Portali Express, "Mesazh i qartë i Gjermanisë pas zgjedhjeve: Serbia duhet ta njoh Kosovën", 17 mars 2014. I qasshëm në, <http://www.gazetaexpress.com/lajme/mesazh-i-qarte-i-gjermanise-pas-zgjedhjeve-serbia-duhet-ta-njoh-kosoven-3556/?archive=1>.](http://www.gazetaexpress.com/lajme/mesazh-i-qarte-i-gjermanise-pas-zgjedhjeve-serbia-duhet-ta-njoh-kosoven-3556/?archive=1)

[Portali Express, "Serbia mund ta heq Kosovën nga Kushtetuta në fund të 2017-s", 8 maj 2015. I qasshëm në, <http://www.gazetaexpress.com/lajme/serbia-mund-ta-heq-kosoven-nga-kushtetuta-ne-fund-te-2017-s-99624/?archive=1>](http://www.gazetaexpress.com/lajme/serbia-mund-ta-heq-kosoven-nga-kushtetuta-ne-fund-te-2017-s-99624/?archive=1)

[Portali INSAJDERI, "Vjosa Osmani thotë se Presidenti Thaçi duhet të jap llogari për Dialogun me Serbinë", 2 mars 2018. I qasshëm në, <http://www.insajderi.com/vjosa-osmani-thote-se-presidenti-thaci-duhet-te-jap-llogari-per-dialogun-serbine/>](http://www.insajderi.com/vjosa-osmani-thote-se-presidenti-thaci-duhet-te-jap-llogari-per-dialogun-serbine/)

[Portali Lajmi.net, "Ministri gjerman: Serbia para se të hyjë në BE duhet ta njoh Kosovën". I qasshëm në, <http://lajmi.net/ministri-gjerman-serbia-para-se-te-hyje-ne-be-duhet-ta-njoh-kosoven/>](http://lajmi.net/ministri-gjerman-serbia-para-se-te-hyje-ne-be-duhet-ta-njoh-kosoven/)

[Portali Telegrafi, "Opozita akuzon Thaçin se nuk po raporton për bisedimet", 22 mars, 2014. I qasshëm në, <https://telegafi.com/opozita-akuzon-thacin-se-nuk-po-raporton-per-bisedimet/>](https://telegafi.com/opozita-akuzon-thacin-se-nuk-po-raporton-per-bisedimet/)

[Portali Telegrafi, "200 mijë nënshkrime në peticionin kundër Asociacionit dhe demarkacionit \(Video\)", 20 tetor, 2015. I qasshëm në, <https://telegafi.com/200-mije-nenshkrime-ne-peticionin-kunder-asociacionit-dhe-demarkacionit-video/>](https://telegafi.com/200-mije-nenshkrime-ne-peticionin-kunder-asociacionit-dhe-demarkacionit-video/)

[Qeveria e Serbisë, Marrëveshja e Drejtësisë në gjuhën serbe. E qasshme në, <http://www.kim.gov.rs/eng/p06.php>](http://www.kim.gov.rs/eng/p06.php)

[Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë \(QKSS\), Barometri Kosovar i Sigurisë: "Edicion Special: Perceptimi Publik për Politikën e Jashtme të Kosovës dhe Dialogun me Serbinë", shkurt 2018. I qasshëm në, \[http://www.qkss.org/repository/docs/KSB-2017-Politika_e_Jashtme_182137.pdf\]\(http://www.qkss.org/repository/docs/KSB-2017-Politika_e_Jashtme_182137.pdf\)](http://www.qkss.org/repository/docs/KSB-2017-Politika_e_Jashtme_182137.pdf)

[Qëndrimi i përbashkët i Bashkimit Europian, Kapitulli 35, 30 nëntor 2015. I qasshëm në, <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/AD-12-2015-INIT/en/pdf>](http://data.consilium.europa.eu/doc/document/AD-12-2015-INIT/en/pdf)

[Radio Evropa e Lirë, "Vetëvendosje me demonstrata kundër ratifikimit të marrëveshjes", 29 maj 2013, e qasshme në <https://www.evropaelire.org/a/25000854.html>](https://www.evropaelire.org/a/25000854.html)

[Radio Evropa e Lirë, "Avni Arifi emërohet përfaqësues i Qeverisë së Kosovës në dialog me Serbinë", 12 janar 2018. I qasshëm në, <https://www.evropaelire.org/a/28971350.html>](https://www.evropaelire.org/a/28971350.html)

[VOA, "Intervistë me Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi" 7 shkurt, 2018. I qasshëm në <https://www.zeriamerikes.com/a/4243121.html>.](https://www.zeriamerikes.com/a/4243121.html)

[Zëri Info, "Ideja e ministrit serb për ndarjen e Kosovës bën bujë në mediat ndërkombëtare". 6 shkurt 2018. I qasshëm në, <http://zeri.info/aktuale/185345/ideja-e-ministrit-serb-per-ndarjen-e-kosoves-ben-buje-ne-mediat-nderkombetare/>.](http://zeri.info/aktuale/185345/ideja-e-ministrit-serb-per-ndarjen-e-kosoves-ben-buje-ne-mediat-nderkombetare/)

[Zëri Info, "Drecun: Thaçi po na ofron shkëmbim terriroresh", 7 maj 2017. I qasshëm në, <http://zeri.info/aktuale/142163/drecun-thaci-po-na-ofron-shkembim-territoresh/>](http://zeri.info/aktuale/142163/drecun-thaci-po-na-ofron-shkembim-territoresh/)

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Marrëveshja e Drejtësisë. E qasshme në, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Marreveshja_per_Drejtesi - 09022015.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Marreveshja_per_Drejtesi_-_09022015.pdf).

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Raportet e ish ministres për dialog. Të qasshme në, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,252>

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, "Platforma e Qeverisë së Republikës së Kosovës për Dialogun Teknik Ndërshtetëror Midis Republikës së Kosovës dhe Republikës Së Serbisë", mars 2011. I qasshëm në, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Platforma_e_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_per_dialogun_teknik_ndersteteror_midis_Republikes_se_Kosoves_dhe_Republikes_se_Serbise.pdf

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Marrëveshja për Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal, 24 shkurt 2012. I qasshëm në, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,191>

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, "Kryeministri Thaçi: Ka fituar opsioni i paqes, stabilitetit dhe integritit", 20 prill 2013. I qasshëm në, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,3499>

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ministria për Dialog, "Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Dialogun e Brukselit /periudha 2014 – 2018/", 15 janar 2015, fq. 6. I qasshëm në, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_i_Qeveris%C3%AB_s%C3%AB_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_per_Dialogun_e_Brukselit_-_periudha_2014-2018_-_150115.pdf

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, "Qeveria e Kosovës ka kërkuar nga Bashkimi Evropian që të ndalen destruksionet e Serbisë ndaj marrëveshjeve të Brukselit", 29 dhjetor, 2017. I qasshëm në, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,6459>

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Vendimi i Qeverisë, Nr. 12/24, miratuar më 12 janar, 2018. I qasshëm në, [www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_së_24-të_të_Qeverisë_së_Republikës_së_Kosovës_2018.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_s%C3%AB_24-t%C3%AB_t%C3%AB_Qeveris%C3%AB_s%C3%AB_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_2018.pdf)

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, "Ekipi negociator i Kosovës për dialogun me Serbinë nis serinë e takimeve në Bruksel", 15 janar 2018. I qasshëm në, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,7485>



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA